



Narrativat e përçarjes: Hartëzimi i dezinformimit të bazuar në identitet në Shqipëri

MONITORIMI I EKOSISTEMIT
TË INFORMACIONIT NË SHQIPËRI
(2022–2025)

Narrativat e përçarjes: Hartëzimi i dezinformimit të bazuar në identitet në Shqipëri

MONITORIMI I EKOSISTEMIT TË INFORMACIONIT
NË SHQIPËRI (2022–2025)

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri
Balkan Investigative Reporting Network Albania
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri
<http://birn.eu.com/>

Autorë: Kristina Voko
Besar Likmeta

Përkthimi: Alma Koçi

Grafika: Jurgena Tahiri

© Balkan Investigative Reporting Network in Albania, Tirana, 2025



**Funded by
the European Union**

Ky studim është financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Opinionet, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e vetme e Balkan Investigative Reporting Network Albania dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	7
Hyrje	9
Shënim Metodologjik	11
Gjetjet Kryesore	14
Dezinformimi i bazuar në identitet në rrjetet sociale	15
Analiza sipas Kuadrit ABCDE të postimeve në rrjetet sociale	17
Aktorët	18
Sjellja	19
Përmbajtja	21
Shkalla	23
Efekti	24
Ndërveprimi	26
Dezinformimi i bazuar në identitet në media	27
Analiza sipas Kuadrit ABCDE e artikujve mediatikë	28
Aktorët	28
Sjellja	30
Përmbajtja	31
Shkalla	33
Efekti	34
Evolucioni i nxitësve kryesorë të dezinformimit të bazuar në identitet, 2022–2025	36
Fokus i veçantë: Ligji për Barazinë Gjinore	38
Dezinformimi dhe kornizimi narrativ në rrjetet sociale	39

Kornizimi i panikut moral	40
Teoritë konspirative	40
Narrativat anti-elitë	41
Stigmatizimi i shoqërisë civile dhe i komunitetit LGBTIQ+	41
Dezinformimi mbi përmbajtjen e projektligjit	42

Angazhimi në rrjetet sociale 42

Narrativa polarizuese në mbulimin mediatik të Ligjit për Barazinë Gjinore	44
--	-----------

Paniku Moral	44
Anti-gjinia	45
Teoritë konspirative	46
Kornizimi fetar i narrativës	47
Narrativa anti-elitë	47
Stigmatizimi dhe dehumanizimi i personave LGBTIQ+	47
Keqinformimi Ligjor	48

Përfundime	49
Rekomandime	51
Shtojca 1: Kodifikimi i rrjeteve sociale	54
Shtojca 2: Kodifikimi i artikujve mediatikë	56

Lista e shkurtesave

ABCDE	Aktor, Sjellje, Përmbajtje, Shkallë, Efekt (Kuari i analizës së dezinformimit)
BE	Bashkimi Evropian
DIMI	Manipulim dhe Ndërhyrje e Brendshme në Informacion
DSA	Akti për Shërbimet Digjitale
EEAS	Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
FIMI	Manipulim dhe Ndërhyrje e Huaj në Informacion
LGBTIQ+	Lezbike, Gay, Biseksualë, Transgjjinorë, Interseks dhe Queer/ Në kërkim të identitetit (+)
MP/MPs	Anëtar i Parlamentit/Anëtarë të Parlamentit
OJQ / OJQ-të)	Organizatë Joqeveritare/Organizata Joqeveritare
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Ky studim dokumenton dhe analizon evolucionin e dezinformimit të bazuar në identitet në ekosistemin mediatik dhe të rrjeteve sociale në Shqipëri gjatë një periudhe trevjeçare. Qëllimi i tij qendror është të thellojë të kuptuarin mbi mënyrën se si narrativa të tilla instrumentalizohen nga aktorë vendas dhe të huaj për të përkeqësuar ndarjet shoqërore, për të stigmatizuar grupet minoritare dhe për të gërryer besimin publik në institucionet demokratike dhe në shtetin e së drejtës. Të dhënat disavjeçare tregojnë se dezinformimi i bazuar në identitet nuk u shfaq papritur; përkundrazi, ai u intensifikua gradualisht përgjatë disa cikleve ngjarjesh politike, kulturore dhe ndërkombëtare, duke kulmuar me fushatën shumë të koordinuar kundër Ligjit për Barazinë Gjinore në vitin 2025.

Studimi mbështetet në kuadrin analitik të përdorur në vlerësimet evropiane mbi dezinformimin e bazuar në identitet, duke e përshtatur atë me peizazhin specifik mediatik të Shqipërisë dhe zhvillimet socio-politike gjatë periudhës së mbuluar nga studimi. Kjo qasje i mundëson analizës të hartëzojë jo vetëm përmbajtjen e dezinformimit, por edhe aktorët, nxitësit dhe dinamikat e amplifikimit që formësojnë përhapjen e tij.

Në vitet e fundit, mjedisi informativ në Shqipëri është bërë gjithnjë e më i ndjeshëm ndaj narrativave që shfrytëzojnë vijat e ndarjes identitare—veçanërisht ato të lidhura me gjininë, seksualitetin, migracionin, fenë dhe vlerat familjare. Të ndikuara pjesërisht nga diskurse globale konservatore, këto narrativa i paraqesin të drejtat e LGBTIQ+, reformat për barazinë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës për seksualitetin si kërcënime ndaj kulturës kombëtare dhe familjes tradicionale. Në nivel lokal, këto korniza janë përqaftuar dhe amplifikuar nga aktorë politikë konservatorë, grupe interesi dhe segmente të medias që synojnë mobilizimin e mbështetjes përmes polarizimit kulturor dhe moral.

Roli dominues i rrjeteve sociale si burimi kryesor i lajmeve për një pjesë të madhe të popullsisë ka përshpejtuar përhapjen e këtyre narrativave. Sistemet algoritmike të shpërndarjes favorizojnë përmbajtjen emocionale dhe sensacionaliste, ndërsa dinamikat e “dhomave të jehonës” përforcojnë ekspozimin ndaj pikëpamjeve ekstreme. Përdorimi i koordinuar i *hashtag*-eve, publikimet ndërplatforma dhe teknikat e synuara të amplifikimit u mundësojnë më tej aktorëve të dezinformimit të arrijnë audiencë të gjera dhe të segmentuara ideologjikut.

Këto dinamika zhvillohen brenda një tregu mediatik shumë të përqendruar dhe të rreshtuar politikisht. Konsolidimi i pronësisë, pavarësia e dobët editoriale dhe presionet komerciale kufizojnë pluralizmin dhe mundësojnë që përmbajtja e orientuar nga agjenda të kalojë lehtësisht nga margjinat në qendër të vëmendjes publike. Si rezultat, mesazhe që dikur qarkullonin kryesisht mes aktorëve periferikë tashmë janë të integruara në qendër të debatit publik në Shqipëri. Dezinformimi i bazuar në identitet shpërndahet në mënyrë të rregullt nga transmetues të mëdhenj, liderë politikë dhe organizata të

motivuar ideologjikisht, shpesh duke ndërthurur elemente faktike me shtrembërime. Në këtë mjedis, diskriminimi ndaj komuniteteve LGBTIQ+ ose ndaj mbrojtësve të barazisë gjinore ri-kornizohet gjithnjë e më shpesh si një mbrojtje legjitime e identitetit kulturor ose kombëtar.

Në këtë kontekst, studimi në fjalë hartëzon rrjedhën dhe forcimin e narrativave të dezinformimit të bazuar në identitet përgjatë ekosistemit hibrid informativ të Shqipërisë. Ai gjurmon mënyrën se si narrativa të tilla lindin, si amplifikohen dhe cilat audiencë mobilizojnë. Ndërsa fokusi kryesor është konteksti kombëtar, analiza kontribuon gjithashtu në përpjekjet më të gjera evropiane për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj manipulimit të huaj dhe vendas, për të mbrojtur komunitetet e cënueshme dhe për të kundërshtuar dëmet digjitale.

Duke kombinuar analizën sasiore të grupeve të mëdha të të dhënave nga rrjetet sociale me kodimin cilësor të përmbajtjes së mbulimit mediatic, studimi ofron një pasqyrë të bazuar në të dhëna mbi mënyrën se si operon dezinformimi i bazuar në identitet në Shqipëri. Gjetjet synojnë të informojnë zhvillimin e politikave, reformat institucionale, nismat për ngritjen e kapaciteteve dhe përpjekjet e komunikimit strategjik që kanë për qëllim forcimin e qëndrueshmërisë demokratike dhe kohezionit shoqëror përballë fushatave të koordinuara të dezinformimit.

Shënim Metodologjik

Sipas Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), dezinformimi i bazuar në identitet përfshin përhapjen e pretendimeve mashtruese ose të rreme që lidhen me gjininë, seksualitetin, racën, etninë, fenë dhe tregues të tjerë identitarë, me qëllim heshtjen, minimin ose shtypjen e komuniteteve të marginalizuara. Qëllimi është shpesh nxitja e frikës, urrejtjes ose mosbesimit, si dhe polarizimi apo manipulimi i diskursit publik, destabilizimi i kohezionit shoqëror, gërryerja e besimit në proceset demokratike dhe shfrytëzimi i cenusshmërive shoqërore për përfitime strategjike.¹

Ky studim fokusohet në mënyrë të veçantë në narrativat e dezinformimit që synojnë individët LGBTIQ+, personat me shprehje gjinore jo-konformuese, si dhe tematikat “pro-familje” ose “anti-woke” në debatin publik. Përhapja e këtyre narrativave u gjurmua në kanale të ndryshme të rrjeteve sociale (Facebook, Instagram dhe TikTok), si dhe në media kryesore dhe ato të djathta, me qëllim kuptimin e frekuencës, shtrirjes dhe retorikës së këtyre fushatave të dezinformimit. EEAS e ka identifikuar tashmë dezinformimin e bazuar në identitet si një kërcënim hibrid brenda kontekstit më të gjerë të manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj informative (FIMI), duke theksuar se ai shpesh shfrytëzon ndjeshmëritë kulturore, fetare dhe historike për të minuar kohezionin shoqëror. Dezinformimi i bazuar në identitet konsiderohet veçanërisht i vështirë për t’u kundërshtuar, pasi ai shfrytëzon kundërvëniet të rreme, si vlerat tradicionale kundrejt devijimit ose vlerat familjare kundrejt degradimit moral, të cilat mbështeten në paragjykimet të rrënjosura në shoqërinë shqiptare.

Në kontekstin shqiptar, fushatat e dezinformimit të bazuar në identitet shpesh ndërthuren me retorikën ekzistuese konservatore ose nacionaliste, e cila i paraqet të drejtat e individëve LGBTIQ+ si një import të huaj, të imponuar nga organizma ndërkombëtarë të udhëhequr nga një agjendë globaliste, që pretendohet se bie ndesh me vlerat më tradicionale kombëtare. Ky studim adopton një qasje shumëdimensionale në shqyrtimin e dezinformimit të bazuar në identitet, jo vetëm si fenomen komunikimi, por si një instrument strategjik politik, i cili kërkon kuptimin e marrëdhënies ndërmjet retorikës së mesazhit, aktorit dhe gjuhës së ngarkuar emocionalisht që përdoret për të amplifikuar shtrirjen e tij në mediat kryesore.

Kjo qasje përdor analizën sipas Kuadrit ABCDE², i cili e zbërthen problemin e dezinformimit në faktorë operativë më të vegjël që mund të formulohen si pyetje analitike. Elementet kryesore të kuadrit përbëhen nga pesë komponentët ABCDE: aktori, sjellja, përmbajtja, shkalla dhe efekti.³

¹ European External Action Service. (2024, November 8). Safeguarding democracy: Building resilience against identity-based disinformation. https://www.eeas.europa.eu/eeas/safeguarding-democracy-building-resilience-against-identity-based-disinformation_en

² ABCDE i referohet inicialeve në gjuhën angleze të Actor (aktori), Behavior (sjellja), Content (përmbajtja), Degree (shkalla), Effect (efekti).

³ Pamment, J. (2020, September 24). The EU’s role in fighting disinformation: Crafting a disinformation framework. Carnegie Endowment for International Peace. <https://carnegieendowment.org/research/2020/09/the-eus-role-in-fighting-disinformation-crafting-a-disinformation-framework?lang=en>

Për të vlerësuar përhapjen e dezinformimit të bazuar në identitet në peizazhin mediatik dhe të rrjeteve sociale në Shqipëri, u formulua një sërë pyetjesh kërkimore, me qëllim orientimin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të fushatave të synuara. Këto pyetje u hartuan për të eksploruar dinamikat retorike dhe kohore të narrativave të dezinformimit që përdoren për të synuar grupet minoritare, veçanërisht komunitetin LGBTIQ+.

Studimi synon t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore të mëposhtme:

1. Cilat ishin narrativat kryesore të dezinformimit të bazuar në identitet që qarkulluan në median tradicionale dhe në rrjetet sociale në Shqipëri ndërmjet viteve 2022 dhe 2025?
2. Cilët aktorë—përfshirë media, figura politike, influencerë apo organizata—janë më aktivë në shpërndarjen e këtyre narrativave?
3. Cili është vëllimi dhe shpërndarja relative e këtyre narrativave në kohë, dhe si lidhen ato me ngjarje kyçe politike ose shoqërore?
4. Cilat strategji retorike, diskursive dhe vizuale përdoren për të shpërndarë dezinformimin e bazuar në identitet në rrjetet sociale?
5. Çfarë modele amplifikimi dhe ndërveprimi shfaqen ndërmjet mediave kryesore dhe platformave të rrjeteve sociale?

Për të monitoruar dhe mbledhur përmbajtjen përkatëse, studimi përdori SentiOne, një mjet për dëgjim dhe monitorim të rrjeteve sociale, i cili u mundëson studiuesve të mbledhin të dhëna si nga media tradicionale ashtu edhe nga një gamë e gjerë platformash digjitale. Kapacitetet e SentiOne përfshijnë filtrimin e bazuar në fjalë kyçe dhe funksione kërkimi historik, duke e bërë atë të përshtatshëm për gjurmimin e dezinformimit përgjatë një periudhe disavjeçare. SentiOne u konfigurua për të mbledhur përmbajtje nga një listë e përzgjedhur prej mbi 30 mediash online dhe 35 llogarish publike në rrjete sociale të lidhura me politikanë, aktivistë, influencerë dhe organizata me orientim ideologjik. Monitorimi përfshiu postime në Facebook, Instagram dhe TikTok, si dhe artikuj lajmesh, opinione dhe editoriale nga faqet e stacioneve kombëtare televizive dhe portalet digjitale të medias.

Për të kapur gjerësinë e plotë të dezinformimit të bazuar në identitet në Shqipëri, kërkimi zbatoi një strategji me dy burime që përfshinte si mediat kryesore, ashtu edhe llogari me ndikim në rrjetet sociale. Procesi i përzgjedhjes u ndërtua për të pasqyruar diversitetin e peizazhit mediatik shqiptar, duke përfshirë organizata të konsoliduara të lajmeve dhe platforma digjitale në zhvillim, si dhe aktorë me orientim ideologjik të djathtë. Qëllimi ishte të sigurohej që grupi i të dhënave të përfshinte jo vetëm narrativa me qarkullim të gjerë, por edhe ato që burojnë nga burime periferike ose të motivuara ideologjikisht, të cilat shpesh shërbejnë si inkubatorë për dezinformimin e bazuar në identitet. Kjo qasje gjithëpërfshirëse mundësoi një vlerësim të plotë të mënyrës se si narrivat e bazuara në identitet prodhohen, shpërndahen dhe amplifikohen nëpër kanale të ndryshme komunikimi.

Metodologjia u zhvillua për të kapur si tendencat afatgjata të narrativave, ashtu edhe shpërthimet intensive të dezinformimit të nxitura nga ngjarje politike ose kulturore, përfshirë debatin rreth Ligjit për Barazinë Gjinore në vitin 2025, i cili u shndërrua në një pikë kthese të rëndësishme në mjedisin informativ të Shqipërisë. Kërkimi bazohet në katër grupe kryesore të dhënash, të mbledhura përmes mjetit të monitorimit të rrjeteve sociale SentiOne. Këto përfshijnë dy grupe të dhënash me artikuj mediatikë dhe postime në rrjetet sociale që përmbajnë narrativa të dezinformimit të bazuar në identitet, duke mbuluar periudhën 1 korrik 2022–30 qershor 2025. Dy grupe të tjera të dhënash me artikuj mediatikë dhe postime në rrjetet sociale mbulojnë periudhën 15 shtator 2025–15 nëntor 2025, duke u fokusuar në mënyrë specifike në narrativat e dezinformimit dhe kornizimin narrativ lidhur me Ligjin për Barazinë Gjinore.

Metodologjia e këtij studimi u hartua për të qenë rigorozë dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë, duhet pranuar se ajo përfshinte disa kufizime. Filtrimi i postimeve në rrjetet sociale dhe artikujve mediatikë bazuar në fjalë kyçe mundësoi përpunimin e një korpusi të madh përmbajtjesh. Megjithatë, mbështetja në këtë teknikë ka gjasa të ketë përjashtuar postime që përdornin gjuhë të koduar. Grupi i postimeve dhe artikujve të analizuar u formësua nga burimet e përzgjedhura dhe nga platformat e përfshira në monitorim. Postimet e disa aktorëve në rrjetet sociale nuk ishin të aksesueshme për shkak të kufizimeve të privatësisë në llogaritë e tyre. Megjithëse procesi i kodimit njerëzor luan një rol të rëndësishëm për të garantuar saktësi kontekstuale dhe nuancë analitike, ai gjithashtu sjell një element subjektiviteti. Kufizimet e sipërpërmendura theksojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm metodologjik dhe për përdorimin e qasjeve plotësuese në kërkimet e ardhshme mbi dezinformimin e bazuar në identitet.

Gjatë periudhës trevjeçare të monitorimit, dezinformimi i bazuar në identitet u shfaq si një nga format më të qëndrueshme dhe të përdorura në mënyrë strategjike të manipulimit në mjedisin informativ të Shqipërisë. Këto narrativa mbështeten në simbole të rrënjësura në aspektin kulturor—familja, feja, rolet gjinore, identiteti kombëtar—për të aktivizuar ankth shoqëror, për të stigmatizuar grupet minoritare dhe për të polarizuar opinionin publik. Aktorë politikë, grupe advokimi dhe media të rreshtuara me ta i kanë paraqitur vazhdimisht të drejtat e LGBTIQ+, reformat për barazinë gjinore, ankthin demografik dhe ndikimin e huaj si kërcënime ekzistenciale ndaj shoqërisë shqiptare, duke ndërthurur ngjarje faktike me shtrembërime, pretendime konspirative dhe panik moral.

Monitorimi tregon se këto narrativa nuk shfaqen në izolim. Ato intensifikohen rreth ngjarjeve politike, kulturore dhe ndërkombëtare me dukshmëri të lartë dhe amplifikimi i tyre ndjek një model të përsëritur: shpërndarje fillestare në rrjete sociale nga aktorë politikë ose advokimi, qarkullim i shpejtë përmes faqeve partiake dhe atyre me fokus identitar, dhe kalim në rrjedhën kryesore përmes portaleve online që i riprodhojnë pa verifikim. Ky ekosistem e normalizon dezinformimin si debat legjitim, gërryen besimin në institucione dhe në shoqërinë civile, dhe ngushton hapësirën për diskutim publik të bazuar në fakte.

Efekti kumulativ i këtij mjedisi është i dukshëm në përshkallëzimin e narrativave polarizuese dhe në sofistikimin në rritje të manipulimit të bazuar në identitet gjatë periudhës së monitoruar. Këto prirje krijuan terrenin për fushatën në shkallë të gjerë të dezinformimit kundër Ligjit për Barazinë Gjinore në vjeshtën e vitit 2025, ku teknikat, aktorët dhe kornizat e dokumentuara përgjatë tre viteve u ndërthurën me intensitet të paprecedentë.

Në përputhje me këtë progresion, gjetjet e këtij kapitulli ndahen në tre seksione:

1. Një analizë e dezinformimit të bazuar në identitet që qarkulloi në rrjetet sociale (korrik 2022–qershor 2025), duke shqyrtuar aktorët, narrativat, modelet e sjelljes dhe dinamikat e ndërveprimit që formësuan mjedisin informativ online.
2. Një analizë e dezinformimit të bazuar në identitet në rrjetet online (korrik 2022–qershor 2025), duke evidentuar mënyrën se si portalet mediatike dhe transmetuesit i amplifikuan, legjitimuan ose ri-kornizuan këto narrativa brenda diskursit publik kryesor.
3. Një shqyrtim i fokusuar mbi valën e dezinformimit rreth Ligjit për Barazinë Gjinore (15 shtator–15 nëntor 2025), fushata më intensive e manipulimit të bazuar në identitet e regjistruar gjatë periudhës së monitorimit, e nxitur nga mesazhe të koordinuara politike, kornizim i panikut moral, narrativa konspirative dhe retorikë mobilizuese.

Së bashku, këta tre komponentë ilustrojnë jo vetëm shkallën dhe qëndrueshmërinë e dezinformimit të bazuar në identitet në Shqipëri, por edhe mënyrën se si evolucioni i tij kumulativ krijoi kushtet për fushata shumë të koordinuara, të afta për të riformësuar debatin kombëtar dhe për të mobilizuar ndarje shoqërore.

Dezinformimi i bazuar në identitet në rrjetet sociale

Ky seksion shqyrton mënyrën se si dezinformimi i bazuar në identitet operon brenda mjedisit të rrjeteve sociale në Shqipëri, duke u fokusuar në përmbajtjen në Facebook, Instagram dhe TikTok të prodhuar ndërmjet korrikut 2022 dhe qershorit 2025. Duke u mbështetur në një grup të dhënash prej 297 postimesh të hartuara nga aktorë politikë, grupe advokimi, faqe mediatike dhe influencerë, analiza trajton si formatet e përdorura, ashtu edhe narrativat që ato promovojnë. Gjetjet tregojnë se rrjetet sociale funksionojnë si një laborator dhe amplifikues kyç për dezinformimin e bazuar në identitet, ku kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe ai i “familjes tradicionale”, narrativat e kërcënimit demografik, teoritë konspirative mbi ndërhyrjen e huaj dhe mesazhet e kornizuara në mënyrë fetare paktohen në formate shumë emocionale dhe interaktive. Duke gjurmuar se kush i prodhon këto postime, si kornizohen ato dhe si angazhohen audiencat me to, ky seksion thekson rolin qendror të platformave sociale në normalizimin e narrativave përçarëse identitare dhe në përkthimin e tyre në mobilizim politik.

Postimet e analizuara përfshijnë postime standarde, video dhe *reels*-a, duke reflektuar gamën e formateve të përdorura për shpërndarjen e dezinformimit të bazuar në identitet. Narrativa më e spikatur është kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe ai i “familjes tradicionale”, i cili i paraqet të drejtat e LGBTIQ+ dhe politikat për barazinë gjinore si imponime të huaja që kërcënojnë kulturën shqiptare dhe jetën familjare. Ngushtësisht e lidhur me këtë është narrativa e “kërcënimit demografik” ose e shpopullimit, e cila sugjeron se migracioni, rënia e lindshmërisë dhe reformat progresive janë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të dobësuar kombin shqiptar. Një temë e tretë e shpeshtë është narrativa e ndërhyrjes së huaj ose konspiracioni “Soros”, ku organizatat joqeveritare (OJQ), organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat perëndimore paraqiten si orkestruese të ndryshimeve të padëshiruara shoqërore. Kornizimi identitar fetar shfaqet gjithashtu shpesh, duke i pozicionuar vlerat tradicionale të bazuara në besim si të sulmuara nga reformat liberale. Së bashku, këto narrativa përforcojnë polarizimin duke e paraqitur ndryshimin shoqëror si një përballje ndërmjet identitetit “autentik” shqiptar dhe ndikimit të jashtëm, duke delegjitimuar aktorët e reformës dhe duke thëlluar mosbesimin ndaj institucioneve dhe shoqërisë civile.

Një grupim i veçantë postimesh përqendrohet në refuzimin e të ashtuquajturës “kulturë woke” dhe narrativave të “ideologjisë gjinore”. Këto narrativa i paraqesin politikat e barazisë gjinore, gjuhën gjithëpërfshirëse, të drejtat e prindërimit për çiftet e të njëjtit seks dhe nismat për diversitet si një agjendë e koordinuar e imponuar ndaj Shqipërisë nga jashtë. Postimet shpesh i kornizojnë koncepte

si “prindi 1/prindi 2” ose njohjen e familjeve jo-tradicionale si kërcënime ndaj fëmijëve, traditave kombëtare dhe vlerave fetare, duke akuzuar OJQ-të dhe partnerët ndërkombëtarë për importimin e një ideologjie të huaj. Ky kornizim i shërben një funksioni të dyfishtë: delegjitimon si lëvizjet për të drejtat e minoriteteve, ashtu edhe institucionet që i mbështesin ato, ndërsa njëkohësisht mobilizon audiencat rreth mbrojtjes së një identiteti “autentik” shqiptar. Në praktikë, narrativa e “kulturës woke” funksionon si një urë lidhëse ndërmjet dezinformimit anti-LGBTIQ+ dhe teorive konspirative mbi ndërhyrjen e huaj, duke amplifikuar frikën nga erozioni kulturor dhe duke përforcuar perceptimin se reformat shoqërore drejtohen nga faktorë të jashtëm.

Narrativat kryesore të dezinformimit të identifikuar në grupin e të dhënave janë të lidhura ngushtë me një sërë ngjarjesh politike, kulturore dhe shoqërore me dukshmëri të lartë, të cilat krijuan terren të favorshëm për amplifikimin e tyre. Lojërat Olimpike Paris 2024 dhe transmetimi i filmit të Disney-t *Strange World* u përdorën për të sulmuar dukshmërinë e LGBTIQ+, duke e kornizuar atë si imponim të “vlerave të panatyrshme” ndaj fëmijëve dhe shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, polemikat rreth ilustrimeve në një tekst të gjuhës shqipe për klasën e tretë u paraqitën si dëshmi e “ideologjisë gjinore” që po depërton në shkolla, ndërsa diskutimet mbi Projektligjin për Shëndetin Riprodhues dhe strehimin social për individë LGBTIQ+ u kornizuan si kërcënime të udhëhequra nga shteti ndaj familjes tradicionale. Ciklet zgjedhore—veçanërisht zgjedhjet lokale të vitit 2023 dhe ato parlamentare të vitit 2025—shërbyen gjithashtu si pika kryesore, ku liderë politikë ndërthurën dezinformimin e bazuar në identitet me retorikën më të gjerë elektorale.

Këto narrativa u përforcuan përmes referencave ndërkombëtare, përfshirë citime të deklaratave të Donald Trump mbi “dy gjinitë”, kritika ndaj Samitit të Bashkimit Evropian dhe teori konspirative të lidhura me Alexander Soros dhe Fondacionet për Shoqërinë e Hapur. Edhe evente si Parada e Krenarisë dhe terminologji si “prindi 1/prindi 2” u instrumentalizuan për ta paraqitur Shqipërinë si një vend nën rrethim kulturor. Së bashku, këto raste tregojnë se si dezinformimi i bazuar në identitet kapet pas ngjarjeve aktuale për të maksimizuar rezonancën, për të polarizuar opinionin publik dhe për të legjitimuar agjenda më të gjera politike.

Një grupim tjetër i rëndësishëm i dezinformimit lidhet specifikisht me Lojërat Olimpike Paris 2024, ku një numër i konsiderueshëm postimesh e përdorën këtë ngjarje si pikë hyrëse për narrativa të bazuara në identitet. Këto postime, të prodhuara kryesisht nga politikanë të opozitës, grupe advokimi konservatore dhe influencerë, e paraqitën pjesëmarrjen e sportistëve transgjinorë si provë se “ideologjia woke” po minon sportin dhe kulturën globale. Lojërat u portretizuan në mënyrë të përsëritur si simbol i rënies morale të Perëndimit, në kontrast me thirrjet për mbrojtjen e “vlerave autentike shqiptare” të rrënjosura në familje, fe dhe traditë. Në këtë mënyrë, një ngjarje sportive globale u përvetësua për të përforcuar dezinformimin e bazuar në identitet në nivel vendas, duke lidhur debatet ndërkombëtare mbi identitetin gjinor në sport me frikën nga erozioni kulturor brenda vendit. Kjo përputhje pasqyron nga afër fushata më të gjera të manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj informative (FIMI), në të cilat aktorë të lidhur me Rusinë amplifikuan histori të fabrikuar mbi sportistët transgjinorë dhe “ideologjinë gjinore” në Olimpiadë. Aktorë shqiptarë i ripaketuan këto narrativa për audiencat vendase, duke përdorur Lojërat për të delegjitimuar institucionet perëndimore dhe për të mobilizuar mbështetës rreth retorikës së mbrojtjes kulturore.

Një tjetër ngjarje rreth së cilës u grumbulluan narrativa të dezinformimit të bazuar në identitet ishte publikimi i filmit të animuar të Disney-t *Strange World* në vitin 2022, që përfshinte personazhin e parë adoleshent hapur homoseksual të studios. Postimet e lidhura me këtë polemikë—kryesisht të prodhuara nga grupe advokimi konservatore—e kornizuan filmin si përpjekje për të indoktruar fëmijët me përmbajtje LGBTIQ+ dhe akuzuan OJQ-të dhe partnerët ndërkombëtarë për gërryerjen e vlerave familjare shqiptare. Debati u ushqye më tej nga referenca ndaj sfidave gjyqësore dhe fushatave të udhëhequra nga aktivistë, ndërsa bllokimi i shfaqjes së filmit në kinematë shqiptare u paraqit si “fitore” kundër imperializmit kulturor. Ky episod ilustron se si produkte kulturore globale ripërdoren nga aktorë vendas për të ndërthurur retorikën anti-LGBTIQ+ me narrativa mbi ndërhyrjen e huaj dhe thirrje mobilizuese, duke përforcuar polarizimin.

Gjatë cikleve zgjedhore, dezinformimi i bazuar në identitet intensifikohet dhe përdoret në mënyrë më të qëllimshme strategjike. Si në zgjedhjet e vitit 2023 ashtu edhe në ato të vitit 2025, aktorë politikë dhe grupe advokimi të lidhura me ta e kornizuan procesin zgjedhor si një betejë për mbrojtjen e identitetit shqiptar nga agjenda të jashtme. Narrativat më të spikatura përfshinin pretendime se të drejtat e LGBTIQ+ dhe reformat për barazinë gjinore ishin pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të “korrupuar” rininë, se migracioni dhe rënia demografike ishin tentativa të qëllimshme për të dobësuar kombin, si dhe se OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat po manipulonin politikën e brendshme. Këto narrativa shfaqeshin shpesh krahas thirrjeve për mobilizim, duke u bërë apel votuesve të mbronin “fenë, familjen dhe kombin” në kutinë e votimit. Në këtë mënyrë, dezinformimi i bazuar në identitet funksionoi si një instrument fushate, duke mjegulluar kufirin ndërmjet mesazhit politik dhe dezinformimit, dhe duke përforcuar polarizimin rreth çështjeve thelbësore kulturore dhe shoqërore.

Analiza sipas Kuadrit ABCDE të postimeve në rrjetet sociale

Procesi i kodimit evidentoi aktorët përgjegjës për prodhimin ose amplifikimin e përmbajtjes (A), sjelljet e përdorura për përhapjen e saj (B), si dhe përmbajtjen dhe kornizimin e narrativave (C), me vëmendje të veçantë ndaj temave anti-LGBTIQ+, frikërave demografike dhe pretendimeve për ndërhyrje të huaj. Gjithashtu u vlerësua shkalla e intensitetit (D)—nga shtrembërime të nivelit të ulët deri te mesazhe të ngarkuara emocionalisht dhe të orientuara drejt mobilizimit—si dhe efektet (E) që këto postime synonin të prodhonin, përfshirë përforcimin e stigmatizimit, thellimin e polarizimit dhe nxitjen e veprimit jashtë hapësirës online. Nënseksionet në vijim përmbledhin modelet kryesore që dalin nga kjo analizë sipas kuadrit ABCDE.

Aktorët

Grupi i të dhënave tregon se shumica e dezinformimit të bazuar në identitet në rrjetet sociale në Shqipëri buron nga një grup i ngushtë aktorësh. Pjesa më e madhe e postimeve të analizuara u prodhua ose u shpërnda nga *liderë politikë ose përfaqësues të partive politike*, të cilët përbënin 46.1% të të gjithë përmbajtjes së identifikuar. *Aktivistët dhe grupet e advokimit* përbënin një burim tjetër të konsiderueshëm, duke kontribuar me 35.7%. Së bashku, këto dy kategori konfirmojnë se agjendat politike dhe ideologjike janë shtytësit kryesorë të narrativave të dezinformimit të bazuar në identitet në mjedisin online shqiptar.

Një pjesë më e vogël, por e dallueshme, e përmbajtjes vinte nga *media dhe gazetarë*, të cilët ishin përgjegjës për 14.8% të postimeve. Në këto raste, aktorët mediatikë ose e riprodhonin drejtpërdrejt dezinformimin, ose e amplifikonin atë përmes raportimit selektiv dhe komenteve. Siç tregohet në Figurën 1, *influencerët në rrjetet sociale* luajtën një rol të kufizuar, por të dukshëm, duke gjeneruar 3.4% të përmbajtjes—kryesisht përmes videove të shkurtra dhe *reels*-ave të dizajnuara për të maksimizuar ndërveprimin.

Në tërësi, përqendrimi i narrativave të dezinformimit te partitë politike, grupet e advokimit dhe mediat e lidhura me to tregon se dezinformimi i bazuar në identitet është në masë të madhe i organizuar dhe i drejtuar nga agjenda, dhe jo rezultat i një aktiviteti të shpërndarë ose spontan online.

Aktorët në postimet në rrjetet sociale




Figura 1: Shpërndarja e aktorëve që prodhojnë dezinformim të bazuar në identitet në rrjetet sociale

Të dhënat e mbledhura mbi postimet në rrjetet sociale që përmbajnë dezinformim të bazuar në identitet nxjerrin në pah një grup qendror liderësh politikë të opozitës si nxitësit më të spikatur të këtyre narrativave në hapësirën sociale online në Shqipëri. Mesazhet e tyre paraqesin shpesh të drejtat e LGBTIQ+, ndryshimet demografike dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile si kërcënime ndaj traditave dhe sovranitetit shqiptar. Duke shfrytëzuar platformat e tyre të konsoliduara dhe ndjekësit e shumtë online, këta liderë politikë e normalizojnë dezinformimin e bazuar në identitet dhe garantojnë qarkullimin e tij të gjerë, duke përforcuar modelet e polarizimit politik.

Liderët politikë mbështeten në dezinformimin e bazuar në identitet si një instrument strategjik për të mobilizuar mbështetësit, për të delegitimuar kundërshtarët dhe për të zhvendosur debatin publik. Duke i kornizuar çështje si të drejtat e LGBTIQ+, barazia gjinore, prirjet demografike apo aktiviteti i OJQ-ve si sfida ndaj familjes, fesë ose identitetit kombëtar, ata shfrytëzojnë ankthe të thella kulturore. Kjo qasje e zhvendos vëmendjen publike nga dështimet në qeverisje, akuzat për korrupsion ose presionet ekonomike, dhe konsolidon mbështetjen politike rreth temave emocionale të lidhura me identitetin. Këto narrativa krijojnë gjithashtu ndarje të qarta mes “brenda-grupit” dhe “jashtë-grupit”, duke përforcuar besnikërinë mes ndjekësve dhe duke i paraqitur kundërshtarët si të ndikuar nga jashtë ose anti-kombëtarë. Në këtë mënyrë, dezinformimi i bazuar në identitet funksionon jo vetëm si mjet komunikimi, por edhe si strategji mbijetese politike në një mjedis shumë konkurrues dhe të polarizuar.

Përtej liderëve politikë, një pjesë e konsiderueshme e dezinformimit të bazuar në identitet buron nga aktivistë dhe grupe advokimi. Këto grupe shpesh paraqiten si mbrojtës të familjes, traditës dhe vlerave kombëtare, duke prodhuar postime, video dhe *reels*-a që i kornizojnë të drejtat e LGBTIQ+, barazinë gjinore dhe punën e OJQ-ve si kërcënime ekzistenciale ndaj shoqërisë shqiptare. Edhe pse formalisht paraqiten si nisma të pavarura të shoqërisë civile, ato shpesh operojnë në përputhje të ngushtë me narrativat partiake të opozitës. Stili i tyre i komunikimit me bazë “grassroots”—i karakterizuar nga podcast-e, transmetime *live*, meme dhe përmbajtje vizuale të ngarkuara emocionalisht—bën që mesazhet e tyre të jenë shumë të lehta për t’u shpërndarë.. Duke mobilizuar tema si mbrojtja e fëmijëve, morali fetar dhe frika demografike, këto grupe luajnë një rol qendror në normalizimin e dezinformimit të bazuar në identitet dhe në përfshirjen e tij në debatet më të gjera publike. Në praktikë, shumë prej tyre funksionojnë si platforma advokimi të politizuara, duke amplifikuar dezinformimin e bazuar në identitet përmes fushatave të koordinuara në rrjetet sociale, përpjekjeve për mobilizim publik dhe sfidave ligjore ose institucionale.

Sjellja

Sjellja e aktorëve që përhapin dezinformim të bazuar në identitet në rrjetet sociale karakterizohet nga përsëritja, kornizimi emocional dhe taktikat e mobilizimit. Siç paraqitet në Figurën 2, pjesa më e madhe e postimeve—71.4%—bie në kategorinë e *kornizimit të përgjithshëm dhe opinionit*, ku liderë politikë, grupe advokimi dhe influencerë përdorin gjuhë emocionale dhe të ngarkuar me vlera për ta paraqitur dezinformimin si të vetëkuptueshëm ose si “sens i përbashkët”. Këto postime shpesh

thërrasin në ndihmë tema si mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja e familjes, ruajtja e fesë apo rezistenca ndaj “agjendave të huaja”, duke reflektuar kornizimin emocional dhe moral të dokumentuar në analizat e EEAS mbi fushatat e manipulimit të bazuara në identitet.

Një model i dytë i rëndësishëm sjelljeje është *mobilizimi dhe thirrjet për veprim*, që përfaqësojnë 14.5% të postimeve. Këto postime i nxisin ndjekësit të nënshkruajnë peticione, të marrin pjesë në protesta, të bojkotojnë produkte kulturore ose të kundërshtojnë projektligje të caktuara—duke treguar se dezinformimi përdoret jo vetëm për të formësuar opinionin, por edhe për të nxitur aktivizëm jashtë hapësirës online. Një përqindje e ngjashme—14.1%—bie në kategorinë e *deklaratave publike dhe komenteve*, ku fjalime, intervista dhe dalje mediatike ripaketoohen në formate të përshtatura për rrjetet sociale. Në të gjitha kategoritë, aktorët mbështeten vazhdimisht në meme vizuale, video të shkurtra dhe *hashtag*-e, duke thjeshtuar çështje komplekse në slogane të ngarkuara emocionalisht, të dizajnuara për qarkullim të shpejtë. Duke kombinuar formësimin e opinionit me mobilizimin, këto sjellje garantojnë që dezinformimi jo vetëm të konsumohet gjerësisht, por edhe të shpërndalet aktivisht, duke përforcuar ciklet e amplifikimit dhe duke thelluar polarizimin e bazuar në identitet.

Figura 2: Modelet e sjelljes të përdorura për të qarkulluar dezinformim të bazuar në identitet në rrjetet sociale



Grupi i të dhënave tregon se thirrjet për veprim drejtohen kryesisht nga liderë politikë dhe zyrtarë partiakë. Nga 51 postimet e koduara nën këtë kategori sjelljeje, 39 u prodhuan nga aktorë politikë, duke nënvizuar rolin e tyre qendror në shndërrimin e narrativave online në përpjekje të koordinuara mobilizimi. Figura të larta të opozitës ishin ndër më aktivet, duke gjeneruar më shumë se një të tretën e të gjitha postimeve të orientuara drejt mobilizimit. Mesazhet e tyre u bëjnë shpesh thirrje ndjekësve të kundërshtojnë politikat qeveritare, të marrin pjesë në protesta publike ose të “mbrojnë familjen dhe kombin”, duke e kornizuar pjesëmarrjen si detyrë qytetare të lidhur me identitetin kulturor dhe sovranitetin kombëtar. Liderë të partive më të vogla opozitare përdorën thirrje të ngjashme, duke ndërthurur retorikë të ngarkuar emocionalisht me pretendime se vlerat tradicionale janë nën kërcënim. Grupet e advokimit të rreshtuara me agjenda konservatore dhe pro-familje i pasqyruan këto taktika mobilizimi, duke bërë thirrje për peticione, protesta dhe kundërshtim kolektiv ndaj ligjeve apo reformave të paraqitura si të dëmshme për fëmijët, moralin ose vlerat kombëtare.

Për aktivistët dhe grupet e advokimit, modeli dominues i sjelljes mbetet kornizimi i përgjithshëm dhe opinioni, duke përbërë pothuajse 100 postime. Këto grupe mbështeten kryesisht në gjuhë emocionale dhe kornizim kulturor, duke e paraqitur dezinformimin si mbrojtje të fëmijëve, familjes dhe identitetit kombëtar ndaj ndikimit të jashtëm ose “imponimit ideologjik”. Duke i paraqitur narrativat e tyre si intuitivisht të vërteta dhe të rrënjësura në traditë, ato synojnë të normalizojnë dezinformimin e bazuar në identitet brenda debatit publik. Më rrallë, aktivistët angazhohen në deklarata publike dhe komente, duke ripaketuar intervista ose dalje mediatike në formate të shkurtra dhe të lehta për t’u shpërndarë, si dhe në thirrje për veprim që nxisin ndjekësit të marrin pjesë në protesta ose të kundërshtojnë projektligje të caktuara. Ndërsa mobilizimi i drejtpërdrejtë shfaqet herë pas here, ndikimi i tyre kryesor qëndron në kornizimin e debateve shoqërore dhe në përfshirjen e dezinformimit në diskursin e përditshëm online, duke garantuar qarkullimin e tij të gjerë në rrjetet sociale.

Megjithëse mediat dhe gazetarët kontribuojnë me më pak postime sesa aktorët politikë ose aktivistët, modelet e tyre të sjelljes luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në amplifikimin e dezinformimit të bazuar në identitet. Aktiviteti i tyre shfaqet kryesisht në formën e deklaratave publike dhe komenteve, ku pika ekzistuese të diskursit politik ose narrativa të shtrembëruara ripakëtohen në artikuj, reportazhe ose segmente transmetimi. Një numër më i vogël postimesh bie në kategorinë e kornizimit të përgjithshëm dhe opinionit, ku editorializimi ose kornizimi sensacionalist thekson ankthin kulturor—veçanërisht rreth të drejtave të LGBTIQ+ ose reformave në arsim. Në këto raste, aktorët mediatikë funksionojnë më pak si burime neutrale informacioni dhe më shumë si amplifikues, duke zgjeruar shtrirjen dhe legjitimitetin e perceptuar të narrativave të dezinformimit përtej rrethëve partiake dhe drejt debatit kryesor online. Përfshirja e tyre, edhe në nivele të moderuara, ndikon ndjeshëm në mënyrën se si këto narrativa fitojnë dukshmëri dhe besueshmëri brenda ekosistemit më të gjerë informativ.

Përmbajtja

Përmbajtja e dezinformimit të bazuar në identitet në grupin e të dhënave dominohet nga *kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe ai i “familjes tradicionale”,* i cili përbën pjesën dërrmuese të postimeve. Siç paraqitet në Figurën 3, kjo kategori përbën 80.1% të gjithë përmbajtjes së koduar, duke i paraqitur në mënyrë të vazhdueshme barazinë gjinore, diversitetin seksual dhe të drejtat e LGBTIQ+ si kërcënime ndaj kulturës, moralit shqiptar dhe, mbi të gjitha, ndaj fëmijëve. Këto narrativa shpesh i referohen reformave në arsim, produkteve kulturore si filmi i Disney-t, *Strange World*, apo ngjarjeve ndërkombëtare si Lojërat Olimpike, duke i paraqitur ato si dëshmi të rënies morale dhe erozionit kulturor.

Rryma të tjera të rëndësishme përfshijnë *narrativën e kërcënimit demografik ose të shpopullimit,* e cila përfaqëson 11.8% të postimeve. Në këtë rast, migracioni, niveli i ulët i lindshmërisë dhe reformat progresive kornizohen si pjesë e një përpjekjeje të qëllimshme për të dobësuar kombin shqiptar. Një tjetër 8.1% e postimeve bie në kategorinë e *ndërrhyrjes së huaj dhe kornizimit konspirativ “Sorosian”,* ku OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, ambasadat perëndimore dhe aktorët filantropikë paraqiten si promovues të një agjende të imponuar nga jashtë.

Në të gjitha kategoritë, kornizimi identitar fetar shfaqet shpesh, duke mobilizuar vlera konservatore dhe të bazuara në besim për t'iu kundërvënë ndryshimit shoqëror. Së bashku, këto lloje përmbajtjesh tregojnë se si aktorët e dezinformimit shfrytëzojnë ankthin kulturor të lidhur me familjen, fenë, identitetin kombëtar dhe mbijetesën demografike për të delegjitimuar institucionet dhe për të mobilizuar audiencat rreth narrativave mbrojtëse dhe polarizuese.




Figura 3: Kategoritë e përmbajtjes së dezinformimit të bazuar në identitet në platformat e rrjeteve sociale

Kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe ai i "familjes tradicionale" shfaqet si narrativa më mbizotëruese në grupin e të dhënave, e promovuar nga një gamë e gjerë aktorësh. Liderët politikë dhe partitë përbëjnë burimin më të shpeshtë, të ndjekur nga afër nga aktivistë dhe grupe advokimi, mesazhet e të cilëve përputhen ngushtë me retorikën partiake. Mediat dhe gazetarët kontribuojnë në këtë kategori duke amplifikuar pikat e diskutit politik ose aktivist, shpesh duke përdorur gjuhë sensacionale ose moralizuese. Influencerët në rrjetet sociale shfaqen vetëm në mënyrë marginale, por përmbajtja e tyre vizuale dhe videot e shkurtra ndihmojnë në ruajtjen e dukshmërisë së narrative. Veçanërisht i dukshëm është një grup organizatash dhe aleancash konservatore pro-familje, të cilat janë ndër amplifikuesit më të qëndrueshëm të kësaj narrative, duke garantuar përsëritjen dhe qëndrueshmërinë e saj nëpër platforma. Kjo shpërndarje tregon se, ndonëse liderët politikë ofrojnë dukshmëri, rrjetet e advokimit janë thelbësore për ruajtjen e volumit dhe konsistencës së narrative, duke e rrënjësuar thellë kornizimin anti-LGBTIQ+ në diskursin online shqiptar.

Narrativa e kërcënimit demografik ose e shpopullimit, ndonëse me volum dukshëm më të ulët (11.8%), mbetet një shtyllë e fuqishme e dezinformimit të bazuar në identitet. Ajo paraqet zakonisht emigrimin, nivelin e ulët të lindshmërisë dhe reformat shoqërore si komponentë të një rënieje më të gjerë, shpesh të atribuuar dështimit qeveritar ose manipulimit të huaj. Aktorët politikë janë promovuesit kryesorë të kësaj narrative, duke lidhur shpesh ankthin demografik me akuza për tradhti kulturore. Grupet e advokimit i përforcojnë këto pretendime duke e kornizuar ndryshimin demografik si krizë morale, duke paralajmëruar se shqiptarët rrezikojnë "zëvendësimin" përmes migracionit ose përmes adoptimit të vlerave perëndimore. Postimet në këtë kategori shpesh ndërthuren me narrativa anti-

LGBTIQ+, duke sugjeruar se njohja e formave të ndryshme të familjes do të përshpejtojë kolapsin demografik. Pavarësisht frekuencës më të ulët, këto narrativa janë me ndikim të lartë, pasi prekin frikëra të përhapura publike mbi rënien demografike, duke i bërë shtytës të fuqishëm të polarizimit dhe mobilizimit.


Narrativa e ndërhyrjes së huaj dhe konspiracionit "Soros-ian", që përfaqëson 8.1% të përmbajtjes, është një tjetër temë e rëndësishme dezinformimi. Këto postime e paraqesin Shqipërinë si objekt manipulimi nga aktorë të jashtëm—veçanërisht OJQ, partnerë ndërkombëtarë ose fondacione filantropike—të akuzuar për promovimin e të drejtave të LGBTIQ+, barazisë gjinore dhe reformave arsimore si pjesë e një agjende për të gërryer sovranitetin kombëtar dhe autenticitetin kulturor. Edhe këtu, liderët politikë janë më aktivët në qarkullimin e këtyre pretendimeve, duke e kornizuar mbështetjen e huaj për politika të bazuara në të drejta si provë e ndikimit të padrejtë. Grupet e advokimit e përforcojnë këtë narrativë duke përmendur organizata dhe fushata specifike si të "financuara nga Soros", duke i lidhur ato me kërcënime ndaj fëmijëve, moralit ose familjes tradicionale. Këto postime shpesh përfshijnë thirrje për t'u rezistuar "ligjeve të imponuara nga jashtë" ose për të kundërshtuar përfshirjen e OJQ-ve në hartimin e politikave. Edhe pse me peshë më të vogël në volum, kjo narrativë ka ndikim të veçantë, pasi delegjitimon shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë, duke i paraqitur reformat si të diktuar nga jashtë dhe jo si procese të nxitura nga brenda, duke thelluar kështu mosbesimin publik.

Shkalla

Brenda kuadrit ABCDE, dimensionin e shkallës (D) mat intensitetin dhe ndikimin e mundshëm të përmbajtjes së dezinformimit, duke variuar nga shtrembërime të nivelit të ulët deri te narrativa shumë mobilizuese. Siç paraqitet në Figurën 4, analiza tregon se pjesa më e madhe e dezinformimit të bazuar në identitet bie në kategorinë e *intensitetit mesatar*, duke përbërë 79.8% të të gjitha postimeve. Kjo kategori përkufizohet nga nxitës emocionalë—përmbajtje që përdor gjuhë polarizuese, apel ndaj frikës dhe kornizim sensacional për të provokuar indinjatë ose ankth, veçanërisht rreth të drejtave të LGBTIQ+, reformave në arsim dhe kërcënimeve të perceptuara ndaj familjes apo traditës.

Një pjesë më e vogël, por gjithsesi e rëndësishme (8.8%), u kodua si *shkallë e lartë*, duke përfaqësuar dezinformim mobilizues që lidh drejtpërdrejt narrativat e bazuara në identitet me thirrje për veprim, si protesta, peticione ose kundërshtim ndaj projektligjeve. Këto postime e përshkallëzojnë kornizimin emocional në mobilizim të qartë, duke i shndërruar reagimet online në sjellje politike jashtë hapësirës digjitale. Në kontrast, 11.4% e postimeve bien në kategorinë e *shkallës së ulët*, që përfshin forma më të rafinuara të komentimit të shtrembëruar ose raportimit të manipuluar, ku dezinformimi inkorporohet pa sinjale të dukshme emocionale ose mobilizuese. Në tërësi, kjo shpërndarje tregon se, ndonëse manipulimi emocional është mënyra dominuese e dezinformimit të bazuar në identitet në Shqipëri, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes intensifikohet në mënyrë strategjike për të mobilizuar audiencat drejt angazhimit ose rezistencës politike.

Figura 4: Shkalla e intensitetit në dezinformimin e bazuar në identitet në rrjetet sociale



Dezinformimi me shkallë të lartë dominohet pothuajse tërësisht nga liderë politikë dhe parti, të cilët janë përgjegjës për pothuajse të gjitha postimet në këtë kategori. Brenda këtij grupi, figura të larta të opozitës ishin më aktivet, duke prodhuar shumicën e përmbajtjes së orientuar drejt mobilizimit në grupin e të dhënave dhe duke u shfaqur në mënyrë të përsëritur gjatë cikleve të monitorimit. Postimet e tyre me shkallë të lartë përdorin zakonisht mesazhe urgjente dhe të ngarkuara emocionalisht—duke u bërë thirrje mbështetësve të protestojnë, të rezistojnë ndaj reformave qeveritare ose të “mbrojnë familjen dhe kombin”—dhe synojnë të shndërrojnë frikërat e bazuara në identitet në veprim kolektiv.

Në kontrast, aktivistët, grupet e advokimit dhe influencerët në rrjetet sociale përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të përmbajtjes me shkallë të lartë, ndërsa mediat dhe gazetarët janë pothuajse plotësisht të munguar, duke kontribuar vetëm me raste të izoluar. Kjo konfirmon se dezinformimi i orientuar drejt mobilizimit është kryesisht një instrument politik, i përdorur në mënyrë më të qëndrueshme nga liderë opozitarë me ndjekës të shumtë online, ndërsa grupet e advokimit dhe influencerët e përforcojnë këtë mesazh në përmasa dukshëm më të kufizuara.

Efekti

Analiza e dimensionit të efektit (E) tregon se dezinformimi i bazuar në identitet në Shqipëri synon më pak informimin dhe më shumë polarizimin, stigmatizimin dhe mobilizimin. Siç paraqitet në Figurën 5, pjesa më e madhe e postimeve—63.0%—synon të përforcojë sentimentin anti-LGBTIQ+ dhe polarizimin kulturor, duke reflektuar dominimin e narrativave që i paraqesin të drejtat e LGBTIQ+ si kërcënime ndaj familjes, fëmijëve, fesë dhe traditës shqiptare. Një tjetër linjë e dukshme përfshin përpjekjet për të delegjitimuar OJQ-të dhe ndikimin ndërkombëtar (8.1%), ku organizatat e shoqërisë civile, partnerët e huaj dhe institucionet ndërkombëtare paraqiten si agjentë të erozionit kulturor ose të “agjendave të huaja”.

Një tjetër 10.4% e postimeve synon të përforcojë frikën nga shpopullimi dhe të ushqejë mosbesimin ndaj institucioneve, duke lidhur ankthin demografik me narrativa më të gjera të rënies kombëtare. Postimet që synojnë të nxisin veprim jashtë hapësirës online dhe të përforcojnë polarizimin politik përbëjnë një pjesë më të vogël (6.7%), por janë veçanërisht me ndikim, pasi e përkthejnë drejtpërdrejt dezinformimin në thirrje për protesta, rezistencë ose mobilizim qytetar. Pjesa e mbetur prej 11.8% e përmbajtjes bie në kategorinë e formësimit të përgjithshëm të opinionit, duke ilustruar se si dezinformimi i bazuar në identitet operon në disa shtresa të shqetësimit shoqëror dhe sentimentit publik.

Së bashku, këto efekte tregojnë se dezinformimi i bazuar në identitet në Shqipëri nuk është thjesht retorik, por funksionon si një instrument strategjik për të thelluar mosbesimin, për të konsoliduar baza politike dhe për të ngurtësuar vijat e ndarjes kulturore.




Figura 5: Efektet e synuara të dezinformimit të bazuar në identitet në postimet në rrjetet sociale

Postimet që synojnë nxitjen e veprimit jashtë hapësirës online tregojnë se si narrativat e dezinformimit lëvizin me qëllim përtej bindjes online dhe përkthehen në mobilizim në botën reale. Liderët politikë dhe grupet e advokimit janë më të shpeshtë që bëjnë thirrje të tilla, duke i nxitur mbështetësit të marrin pjesë në protesta apo tubime—veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore, debatit mbi projektligjin për shëndetin riprodhues apo çështjeve që lidhen me dukshmërinë e të drejtave të LGBTIQ+. Postime të tjera bëjnë thirrje për bojkot të produkteve kulturore, si filmi i Disney-t, *Strange World*, ose për rezistencë ndaj reformave në arsim të cilësuar si “të imponuara nga jashtë”. Në disa raste, audiencat inkurajoheshin të paraqisnin peticione ose të mbështesnin sfida ligjore kundër institucioneve, ndërsa aktivistët i paraqisnin vendimet gjyqësore si fitore kundër “ideologjisë gjinore”. Këto mesazhe të orientuara drejt mobilizimit përdornin shpesh fëmijët dhe familjen si simbole emocionale mobilizuese, duke synuar ta ri-kornizonin pjesëmarrjen politike si mbrojtje të traditës dhe sovranitetit kombëtar. Edhe pse me volum më të ulët, këto postime dëshmojnë aftësinë

e dezinformimit të bazuar në identitet për të kaluar në sferën offline, duke formësuar sjelljen qytetare dhe duke përforcuar polarizimin politik.

Dezinformimi i bazuar në identitet shënjestron gjithashtu në mënyrë të shpeshtë OJQ-të e bazuara në të drejtat e njeriut, duke i paraqitur ato si agjentë të huaj që minojnë vlerat kulturore shqiptare. Fokusi më i qëndrueshëm është mbi Aleanca LGBT dhe përfaqësuesen e saj publike, Xheni Karaj, të cilat paraqiten si promotore kryesore të “ideologjisë gjinore” dhe akuzohen për korrupsion ose indoktrinim të fëmijëve përmes nismave arsimore dhe eventeve kulturore. Edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi sulmohet në mënyrë të ngjashme, duke u kornizuar si institucion i rreshtuar me “organizata të financuara nga Soros”. OJQ-të që punojnë për të drejtat e grave, shëndetin riprodhues dhe politikat kundër diskriminimit grupohen rregullisht si “projekte të financuara nga jashtë” të imponuara mbi Shqipërinë. Këto sulme intensifikohen gjatë polemikave kulturore, ku OJQ-të pozicionohen si agjentë të ndikimit ideologjik. Duke shënjestruar në mënyrë të përsëritur këto organizata, aktorët e dezinformimit përpiqen jo vetëm të stigmatizojnë të drejtat e LGBTIQ+, por edhe të gërryjnë besimin publik në shoqërinë civile, duke dobësuar legjitimitetin e saj dhe duke reduktuar ndikimin e saj në hartimin e politikave dhe në debatin publik.

Ndërveprimi

Krahas kodimit cilësor të narrativave, databaza e postimeve në rrjetet sociale përfshin edhe tregues të ndërveprimit—komente, shpërndarje dhe reagime—të cilët ofrojnë një pasqyrë mbi dukshmërinë dhe ndikimin e mundshëm të dezinformimit të bazuar në identitet në platforma si Facebook-u, Instagram-i dhe TikTok-u. Në përgjithësi, modelet e ndërveprimit tregojnë se dezinformimi i kornizuar rreth çështjeve identitare tërheq nivele disproporcionale të larta angazhimi, megjithëse intensiteti ndryshon në varësi të aktorit, formatit dhe kornizimit emocional të përmbajtjes.

Mesatarisht, postimet morën rreth 22 komente dhe 139 pëlqime, por kjo mesatare fsheh kulmet e theksuara të gjeneruara nga narrativa shumë polarizuese. Disa nga postimet më kontestuese në databazën e të dhënave arritën pothuajse 2,000 komente dhe afro 9,000 pëlqime, duke ilustruar potencialin e konsiderueshëm viral të përmbajtjes së bazuar në identitet. Këto kulme zakonisht lidhen me postime që shënjestrojnë të drejtat e LGBTIQ+, reformat në arsim ose “ndikimin e huaj”, të cilat në mënyrë të vazhdueshme nxisnin diskutime intensive dhe reagime emocionale.

Shpërndarjet ofrojnë një tjetër tregues të amplifikimit të narrativave. Ndërsa një postim mesatar u shpërnda rreth 11 herë, përmbajtja e orientuar drejt mobilizimit—veçanërisht thirrjet për protesta, kundërshtim të projektligjeve ose “mbrojtje të familjes dhe kombit”—arriti nivele shumë më të larta, me disa postime të shpërndara afro 300 herë. Këto modele të rritura shpërndarjeje tregojnë se narrativat mobilizuese shkojnë përtej audiencës fillestare, duke ndihmuar në integrimin e dezinformimit të bazuar në identitet në debatet më të gjera online dhe në diskutimet politike jashtë hapësirës digjitale.

Reagimet emocionale hedhin më tej dritë mbi mënyrën se si përhapet dezinformimi i bazuar në identitet. Reagimet “love” (zemër/dashuri) dhe “haha” (tallje) ishin ndër më të zakonshmet në përgjithësi, duke reflektuar përdorimin si në mbështetje, ashtu edhe në formë talljeje të këtyre funksioneve. Megjithatë, postimet polarizuese gjeneruan nivele të larta reagimesh “angry”(zemërim), me disa prej tyre që morën mbi 100 reagime zemërimi secili. Kjo përputhet me kërkime më të gjera që tregojnë se dezinformimi përhapet më shpejt kur ngjall reagime të forta emocionale—veçanërisht indignatë, humor ose zemërim moral—ndërsa reagime si “sad” (trishtim) apo “thankful” (falënderues) shfaqeshin shumë rrallë.

Së bashku, këta tregues të ndërveprimit tregojnë se dezinformimi i bazuar në identitet qarkullon jo vetëm sepse është i dukshëm, por sepse është i ngarkuar emocionalisht dhe i përforcuar algoritmikisht. Përmbajtja që performon më mirë është ajo që provokon ndjenja të forta ose mobilizon frikë kolektive, duke u mundësuar narrativave të përhapen me shpejtësi nëpër platforma dhe të thellojnë modelet e polarizimit online. Edhe pse jo të gjitha postimet bëhen virale, ndërveprimi vazhdimisht më i lartë i lidhur me dezinformimin e bazuar në identitet nënvizon kapacitetin e tij për të formësuar debatin publik dhe për të ndikuar mënyrën se si audiencat perceptojnë çështjet shoqërore dhe politike.

Dezinformimi i bazuar në identitet në media

Përtej platformave të rrjeteve sociale, narrativat e dezinformimit të bazuar në identitet janë të rrënjosura thellë edhe në peizazhin e mediave online në Shqipëri, ku portale partiake, komentatorë të rreshtuar politikisht dhe televizione më të vogla luajnë një rol qendror në amplifikimin dhe normalizimin e tyre. Databaza prej 583 artikujsh të publikuar midis korrikut 2022 dhe qershorit 2025 tregon se narrativat e bazuara në identitet—veçanërisht kornizimi anti-LGBTIQ+, pretendimet për kërcënim demografik dhe konspiracionet për ndërhyrje të huaj—paktohen në mënyrë të vazhdueshme si raportim sensacional lajmesh, komente ose pseudo-analiza. Në vend që të gjenerojnë narrativa të reja, shumë media funksionojnë si dhoma jehone, duke ripublikuar ose përshtatur dezinformimin e hedhur fillimisht në rrjetet sociale nga liderë politikë, grupe advokimi ose influencerë, dhe duke i dhënë atij pamjen e kredibilitetit gazetaresk. Të dhënat konfirmojnë se dezinformimi i bazuar në identitet nuk është periferik, por i inkorporuar strukturisht në ekosistemin mediatik shqiptar gjatë periudhës së monitorimit.

Në të gjithë databazën, dezinformimi i bazuar në identitet mblidhet shpesh rreth ngjarjeve politike, kulturore dhe shoqërore me dukshmëri të lartë, të cilat ofrojnë terren të përshtatshëm për amplifikim. Nxitësit më të spikatur përfshinin fitoren e Donald Trump në zgjedhjet në SHBA dhe debatet rreth projektligjit të ashtuquajtur “dy gjini”, të përdorura gjerësisht për të legjitimuar retorikën anti-LGBTIQ+ dhe për ta paraqitur Shqipërinë si rezistuese ndaj “ideologjisë woke”. Projektligji për Shëndetin

Riprodhues dhe ceremonia simbolike e martesës së dy grave lezbike në Tiranë u shndërruan gjithashtu në pika tensioni, duke u paraqitur si sulme ndaj traditës, identitetit kombëtar dhe familjes.

Periudhat zgjedhore—veçanërisht zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2023—ishin një tjetër shtysë kryesore e dezinformimit të bazuar në identitet, ku aktorë politikë dhe media të rreshtuara me ta ndërthurën temat e identitetit kulturor me mesazhet më të gjera të fushatës. Këto narrativa e kornizuan konkurrencën zgjedhore jo thjesht si garë politike, por si betejë për mbrojtjen e identitetit shqiptar nga agjenda të huaja, OJQ dhe reforma progresive. Edhe ngjarje ndërkombëtare si Lojërat Olimpike Paris 2024 u instrumentalizuan, shpesh duke u paraqitur si simbole të degradimit moral perëndimore dhe duke u përdorur për të përforcuar frikën nga erozioni kulturor në vend.

Polemikat lokale e shtuan më tej intensitetin. Histori që lidhen me bonuse strehimi për persona LGBTIQ+, pretendime për simbole LGBTIQ+ në tekstet shkollore apo incidente të izoluara që përfshijnë dukshmërinë e minoriteteve u sensacionalizuan vazhdimisht, duke u mundësuar mediave të riciklojnë narrativa të bazuara në identitet dhe t'i mbajnë ato emocionalisht të pranishme.

Këto modele tregojnë se mediat online në Shqipëri jo vetëm që amplifikojnë dezinformimin e bazuar në identitet, por edhe e lidhin atë në mënyrë strategjike me zhvillimet aktuale politike, debatet kulturore dhe ngjarjet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, ato garantojnë që narrativat identitare të mbeten shumë të dukshme, emocionalisht të ngarkuara dhe thellësisht të integruara në diskursin më të gjerë publik, duke përforcuar polarizimin dhe mosbesimin, ndërsa legjitimojnë agjenda politike të rrënjosura në identitetin kulturor.

Analiza sipas Kuadrit ABCDE e artikujve mediatikë

Në mënyrë të ngjashme me postimet në rrjetet sociale, çdo njësi e databazës prej 583 artikujsh mediatikë u shqyrtua dhe u kodua duke përdorur kuadrin analitik ABCDE për dezinformimin, duke mundësuar një analizë sistematike të aktorëve pas narrativave (A), sjelljeve të përdorura për përhapjen e tyre (B), përmbajtjes dhe kornizimit (C), grupeve identitare të synuara (D), si dhe shkallës dhe efektit të dezinformimit (E).

Aktorët

Dimensioni i aktorëve (A) në databazën e të dhënave të mediave tregon se dezinformimi i bazuar në identitet në lajmet online shqiptare drejtohet kryesisht nga *liderë politikë dhe parti*, të cilët përbëjnë 69.1% të të gjithë artikujve të koduar. Kjo konfirmon rolin qendror të politikanëve në formësimin dhe amplifikimin e narrativave polarizuese të bazuara në identitet, duke përdorur shpesh mediat si kanale për të zgjeruar shtrirjen dhe për të përforcuar mesazhet e tyre.

Një pjesë më e vogël, por e konsiderueshme (10.1%), buron nga vetë *mediat dhe gazetarët*, të cilët luajnë një rol të dyfishtë: në disa raste prodhojnë dezinformim të bazuar në identitet përmes kornizimit sensacionalist, ndërsa në raste të tjera amplifikojnë pikat e diskursit të aktorëve politikë. *Aktivistët dhe grupet e advokimit* kontribuojnë me 8.9% të artikujve, veçanërisht në temat që lidhen me të drejtat e LGBTIQ+, barazinë gjinore dhe reformat në arsim, ndërsa 7.2% e përmbajtjes prodhohet nga *aktorë të paspecifikuar ose anonimë*—zakonisht portale që publikojnë materiale pa autorësi të qartë për të qarkulluar pretendime kontroverze pa llogaridhënie.

Pjesa e mbetur prej 4.6%, e përmbledhur nën kategorinë “*Të tjera*” në Figurën 6, përfshin përmbajtje nga liderë dhe institucione fetare, influencerë në rrjetet sociale dhe media shtetërore të huaja, të cilat shfaqen më sporadikisht, por shpesh në lidhje me narrativa moralizuese ose konspirative. Së bashku, kjo shpërndarje e aktorëve konfirmon se dezinformimi i bazuar në identitet në media është thellësisht i politizuar dhe i drejtuar nga partitë, por përforcohet nga rrjete advokimi dhe forma oportuniste të gazetarisë online, duke krijuar një ekosistem më të gjerë amplifikimi.




Figura 6: Shpërndarja e aktorëve që prodhojnë dezinformim të bazuar në identitet në artikujt mediatikë

Nxitësit më të spikatur të dezinformimit të bazuar në identitet në mediat shqiptare janë politikanë të profilit të lartë të opozitës dhe aleatët e tyre politikë. Figura të larta opozitare dominojnë mbulimin mediatik, duke përdorur narrativa identitare për të sulmuar rivalët, për të delegjitimuar institucionet dhe për të mobilizuar mbështetësit rreth temave kulturore dhe morale. Ata ndiqen nga përfaqësues të tjerë partiakë, të cilët shfaqen vazhdimisht si burime të kornizimit anti-LGBTIQ+, pretendimeve për kërcënim demografik dhe narrativeve konspirative që lidhin OJQ-të ose partnerët ndërkombëtarë me ndërhyrje të huaj.

Jashtë sferës politike, platforma advokimi konservatore dhe grupe pro-familje luajnë një rol të dukshëm në përforcimin e këtyre narrativave, duke i kornizuar ato përmes panikut moral, mbrojtjes kulturore dhe apelimeve ndaj traditës. Media me prirje të djathtë dhe portale me stil tabloid i amplifikojnë më tej këto mesazhe, duke ndërthurur pikat e diskursit politik me raportim sensacional për të rritur dukshmërinë dhe ndërveprimin.

Këto modele tregojnë se dezinformimi i bazuar në identitet në ekosistemin mediatik shqiptar nuk është i shpërndarë në mënyrë të rastësishme apo aksidentale, por i orkestruar dhe i mbajtur gjallë nga një rrjet i përqendruar aktorësh politikë dhe advokimi, të mbështetur nga platforma mediatike të rreshtuara që mundësojnë qarkullimin e tij të vazhdueshëm.


Sjellja

Dimensioni i sjelljes (B) në databazën e të dhënave të mediave tregon se dezinformimi i bazuar në identitet qarkullon kryesisht përmes *kornizimit të përgjithshëm dhe opinioneve*, të cilat përbëjnë 68.6% të të gjithë artikujve. Në këto raste, mediat ripublikojnë fjalime, konferenca për shtyp ose intervista nga politikanë dhe aktivistë—shpesh pa analizë kontekstuale ose verifikim—duke e shndërruar retorikën politike në dezinformim të amplifikuar. Ky riprodhim jokritik u mundëson aktorëve politikë të projektojnë narrativat e tyre shumë përtej platformave të veta, duke përdorur mbulimin mediatik për të legjitimuar pretendime të bazuara në identitet dhe për t'i integruar ato në debatin kryesor publik.

Një pjesë e konsiderueshme e artikujve—26.9%—bie në kategorinë e *mobilizimit dhe thirrjeve për veprim*, ku lexuesit nxiten drejtpërdrejt ose tërthorazi të kundërshtojnë projektligje, të bojkotojnë produkte kulturore, të marrin pjesë në protesta ose të mbështesin fushata të kornizuara si mbrojtje e familjes, traditës apo identitetit kombëtar. Këta artikuj shpesh theksojnë peticione, demonstrata dhe nisma aktiviste të lidhura me çështje si projektligji i ashtuquajtur “dy gjini” apo Projektligji për Shëndetin Riprodhues. Duke e paraqitur mobilizimin si detyrë qytetare të lidhur me mbrojtjen e fëmijëve ose vlerave shqiptare, media luan një rol aktiv në nxitjen e veprimit jashtë hapësirës online dhe në intensifikimin e polarizimit politik.

Një përqindje më e vogël—4.5%—kategorizohet si *raportim mediatik ose kornizim opinioni*, ku tituj sensacionalë, kornizim selektiv dhe gjuhë emocionale përdoren për ta paraqitur dezinformimin si fakt ose si “logjikë e shëndoshë”. Këta artikuj shpesh mbështeten në alarmizëm kulturor ose panik moral, veçanërisht në lidhje me dukshmërinë e LGBTIQ+, reformat në arsim ose nismat ndërkombëtare. Së fundi, një grup i vogël artikujsh mbetet i paspecifikuar, duke reflektuar raste ku sjelljet janë të vështira për t'u klasifikuar, por gjithsesi kontribuojnë në qarkullimin e përgjithshëm të narrativave të bazuara në identitet.

Figura 7: Modelet e sjelljes të përdorura për të qarkulluar dezinformim të bazuar në identitet në artikujt mediatikë



Megjithëse më pak të shpeshta sesa deklaratat publike, artikujt e orientuar drejt mobilizimit përbëjnë një element të rëndësishëm të dezinformimit të bazuar në identitet në media. Ata citojnë shpesh peticione, protesta ose fushata aktiviste, duke e kornizuar pjesëmarrjen si mbrojtje të familjes, traditës dhe identitetit kombëtar. Grupet e advokimit paraqiten shpesh si organizatore të këtyre nismave, ndërsa politikanë të opozitës i amplifikojnë këto thirrje përmes komenteve mbështetëse. Duke përfshirë thirrje për veprim brenda një mbulimi me stil lajmi, mediat u japin legjitimitet dhe dukshmëri më të gjerë narrativave mobilizuese, duke përforcuar ndikimin e tyre dhe duke ndihmuar në përkthimin e dezinformimit online në aktivizëm jashtë hapësirës digjitale.

Përmbajtja

Dimensioni i përmbajtjes (C) në databazën e të dhënave të mediave tregon se dezinformimi i bazuar në identitet në mediat shqiptare është strukturuar në mënyrë dërrmuese rreth *kornizimit anti-LGBTIQ+ dhe atij të "familjes tradicionale"*, i cili përbën 83.9% të të gjithë artikujve të analizuar. Kjo e bën atë narrativën më dominuese në mjedisin mediatik. Artikujt në këtë kategori i paraqesin në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e LGBTIQ+, reformat për barazinë gjinore dhe dukshmërinë e minoriteteve si kërcënime ekzistenciale ndaj kulturës, fesë dhe fëmijëve në Shqipëri. Ata sensacionalizojnë shpesh incidente të izoluara—si ceremoni martesash të të njëjtit seks, materiale mësimore me simbole LGBTIQ+ ose evente kulturore që përfshijnë grupe minoritare—për të amplifikuar panikun moral dhe për t'i paraqitur reformat shoqërore si imponime nga jashtë.

Rryma të tjera, më të vogla por të dallueshme, përfshijnë narrativat e *ndërhyrjes së huaj dhe konspiracionit "Sorosian"* (6.3%), të cilat delegjitojnë OJQ-të, partnerët ndërkombëtarë dhe ambasadat perëndimore duke i paraqitur si nxitës të ndryshimeve kulturore të padëshiruara. Një tjetër 4.1% e artikujve promovon *narrativën e kërcënimit demografik*, duke lidhur migracionin, rënien e lindshmërisë dhe reformat shoqërore me pretendime se Shqipëria po dobësohet në mënyrë të qëllimshme. Krahas këtyre, 5.7% e artikujve bien në kategorinë e *narrativave të përgjithshme politike ose shoqërore*, ku temat identitare inkorporohen në kritika më të gjera ndaj qeverisjes, korrupsionit ose ndryshimeve shoqërore.

Në tërësi, analiza e përmbajtjes konfirmon se, ndonëse qarkullojnë narrativa të ndryshme të bazuara në identitet në ekosistemin mediatik shqiptar, shënjestrimi sistematik i të drejtave të LGBTIQ+, reformave për barazinë gjinore dhe dukshmërisë së minoriteteve përbën tiparin më përcaktues të dezinformimit të bazuar në identitet gjatë periudhës së monitoruar.




Figura 8: Kategoritë e përmbajtjes së dezinformimit të bazuar në identitet në artikujt mediatikë

Kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe ai i "familjes tradicionale" drejtohet kryesisht nga liderë politikë, të cilët përbëjnë shumicën e artikujve të koduar në këtë kategori. Figura të profilit të lartë të opozitës—kryetarë partish, deputetë dhe përfaqësues të lartë—shfaqen dukshëm, duke e pozicionuar veten si mbrojtës të traditës shqiptare kundër të ashtuquajturave "agjenda të huaja". Ata mbështeten nga një rrjet aktivistësh konservatorë dhe grupesh advokimi, të cilat e kornizojnë dukshmërinë e LGBTIQ+ dhe reformat për barazinë gjinore si kërcënime ekzistenciale ndaj familjes, identitetit kombëtar dhe rendit moral.

Mediat, përfshirë portale me stil tabloidi dhe televizione më të vogla, e amplifikojnë më tej këtë retorikë duke ripublikuar deklarata politike dhe komente sensacionale, shpesh pa shqyrtim kritik ose analizë kontekstuale. Kjo dinamikë krijon një ekosistem të ndërthurur, ku aktorët politikë drejtojnë

narrativën, grupet e advokimit ofrojnë kornizimin moral dhe kulturor, dhe platformat mediatike i zmadhojnë të dyja, duke e ngulitur dezinformimin anti-LGBTIQ+ thellë në diskursin kryesor politik.

Shkalla


Analiza e dimensionit të shkallës (D) tregon se dezinformimi i bazuar në identitet në media shfaqet më së shpeshti në formën e *dezinformimit informativ me intensitet të ulët*, i cili përbën 64.5% të të gjithë artikujve. Këto materiale zakonisht përfshijnë shtrembërime, kornizim selektiv ose interpretime të gabuara të inkorporuara brenda raportimit me stil lajmi, duke i dhënë dezinformimit një fasadë besueshmërie dhe duke shmangur sinjale të hapura mobilizimi. Kjo formë e rafinuar përsëritjeje garanton që narrativat e bazuara në identitet të qarkullojnë gjerësisht dhe të duken si të mbështetura në raportim faktik.

Një përqindje më e vogël, por gjithsesi e rëndësishme—14.2%—klasifikohet si *shkallë mesatare*, e karakterizuar nga nxitës emocionalë si tituj sensacionalë, mesazhe të bazuara në frikë dhe gjuhë e ngarkuar moralisht. Këta artikuj synojnë të provokojnë indinjatë ose ankth, veçanërisht në lidhje me dukshmërinë e LGBTIQ+, reformat për barazinë gjinore, ndryshimet demografike dhe pretendimet për ndërhyrje të huaj.

Së fundi, 21.3% e artikujve bien në *kategorinë me shkallë të lartë, të orientuar drejt mobilizimit*. Këto materiale u bëjnë thirrje drejtpërdrejt lexuesve të protestojnë, të kundërshtojnë projektligje, të bashkohen me peticione ose të mbështesin fushata politike të kornizuara si mbrojtje e familjes, traditës ose identitetit kombëtar. Prania e një përqindjeje kaq të konsiderueshme përmbajtjeje me intensitet të lartë tregon se dezinformimi i nxitur nga media jo vetëm që formëson opinionin, por edhe promovon në mënyrë aktive veprim jashtë hapësirës digjitale, duke mjegulluar kufirin midis komunikimit politik dhe dezinformimit.

Shkalla e intensitetit

Figura 9: Shkalla e intensitetit në dezinformimin e bazuar në identitet në artikujt mediatikë



Analiza tregon se dezinformimi me shkallë të lartë, me potencial të qartë mobilizues, drejtohet në mënyrë dërrmuese nga liderë politikë dhe parti, të cilët janë përgjegjës për shumicën e artikujve në këtë kategori. Liderët e opozitës janë veçanërisht të spikatur, duke përdorur shpesh narrativa të bazuara në identitet për të bërë thirrje për protesta, për të kundërshtuar projektligje si i ashtuquajturit ligji “dy gjini” dhe Projektligji për Shëndetin Riprodhues, si dhe për të minuar legjitimitetin e institucioneve qeveritare. Figura të larta brenda partisë kryesore opozitare i kornizojnë në mënyrë të përsëritur çështjet identitare si kërcënime ekzistenciale që kërkojnë veprim të menjëhershëm kolektiv.

Krahas këtyre aktorëve politikë, grupet e advokimit shfaqen si mobilizues kyç, duke organizuar protesta, peticione dhe fushata publike kundër të drejtave të LGBTIQ+ dhe reformave për barazinë gjinore. Mesazhet e tyre përforcohen nga disa media më të vogla ose me prirje partiake, të cilat ripublikojnë thirrjet për mobilizim si përmbajtje lajmi, duke u dhënë kështu thirrjeve politike dhe aktiviste për veprim dukshëm më të gjerë dhe legjitimitet të perceptuar.

Këto modele konfirmojnë se dezinformimi me shkallë të lartë në ekosistemin mediatik shqiptar është thelbësisht i drejtuar politikisht, me grupe advokimi dhe media të rreshtuara që amplifikojnë strategjitë mobilizuese të figurave opozitare dhe kontribuojnë në rritjen e polarizimit.

Efkti

Analiza e dimensionit të efektit (E) tregon se dezinformimi i bazuar në identitet në media synon kryesisht të përforcojë polarizimin kulturor dhe të stigmatizojë grupet minoritare. Siç paraqitet në Figurën 10, rezultati më i shpeshtë është *përforcimi i sentimentit anti-LGBTIQ+ dhe i polarizimit kulturor*, i cili shfaqet në 71.0% të të gjithë artikujve. Kjo konfirmon se sa thellë janë rrënjësuar sulmet ndaj minoriteteve seksuale dhe gjinore në diskursin mediatik shqiptar, duke e pozicionuar dukshmërinë e LGBTIQ+ dhe reformat për barazinë gjinore si kërcënime ndaj traditës, moralit dhe identitetit kombëtar.

Një tjetër 14.1% e artikujve bie në kategorinë e *nxitjes së veprimit jashtë hapësirës online dhe përforcimit të polarizimit politik*, ku dezinformimi i bazuar në identitet lidhet drejtpërdrejt me mobilizimin kundër projektligjeve, eventeve publike ose ndërhyrjes së perceptuar të huaj. Këta artikuj i inkurajojnë lexuesit të kundërshtojnë reformat, të marrin pjesë në protesta, të bojkotojnë produkte kulturore ose të mbrojnë “familjen dhe kombin”, duke dëshmuar se si dezinformimi përdoret si mjet për të shndërruar narrativat online në sjellje politike jashtë hapësirës digjitale.

Pjesë më të vogla, por gjithsesi domethënëse, të databazës synojnë të *delegjitimojnë OJQ-të dhe ndikimin ndërkombëtar* (5.2%), duke i paraqitur organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët perëndimorë si agjentë të ndryshimeve kulturore të padëshiruara, si dhe të *përforcojnë frikën nga shpopullimi* (3.9%), duke shfrytëzuar ankthin publik mbi migracionin, rënien demografike dhe dështimin institucional. Kategoritë e *formësimit të përgjithshëm të opinionit dhe amplifikimit të ndarjeve fetare* (5.8%) shfaqen më rrallë, por ilustrojnë gamën e strategjive të bazuara në identitet të përdorura për të ndikuar qëndrimet publike.

Së bashku, këto efekte tregojnë se mediat shqiptare jo vetëm që shpërndajnë narrativa polarizuese, por edhe ushqejnë aktivisht mosbesimin, stigmatizimin dhe mobilizimin. Dezinformimi i bazuar në identitet është i integruar si në përmbajtjen e përditshme që formëson opinionin, ashtu edhe në mesazhet haptazi politike, duke përforcuar mosbesimin ndaj institucioneve dhe duke ngurtësuar vijat e ndarjes shoqërore dhe kulturore.




Figura 10: Efektet e synuara të dezinformimit të bazuar në identitet në artikujt mediatikë

Analiza tregon se *liderët politikë dhe partitë* janë nxitësit dominues të dezinformimit të bazuar në identitet që synon të inkurajojë veprim jashtë hapësirës online dhe të intensifikojë polarizimin politik. Mes këtyre aktorëve, disa parti opozitare dhe drejtuesit e tyre dallohen për përdorimin e vazhdueshëm të narrativave identitare për të bërë thirrje për rezistencë publike ndaj reformave të kornizuara si kërcënime ndaj familjes, sovranitetit ose traditës kombëtare. Figura të tjera opozitare shfaqen gjithashtu shpesh, duke përdorur retorikë të ngjashme për të mobilizuar mbështetësit kundër rivalëve politikë dhe institucioneve shtetërore, duke përforcuar një model më të gjerë ku narrativat e bazuara në identitet përdoren për të nxitur veprim kolektiv dhe për të minuar legjitimitetin institucional.


Përtej aktorëve politikë, *aktivistët* luajnë gjithashtu një rol të dukshëm në dezinformimin e orientuar drejt mobilizimit. Një aktivist në veçanti shfaqet si burim i spikatur, duke bërë rregullisht thirrje për protesta, bojkot dhe sfida ligjore për të kundërshtuar politika të lidhura me barazinë gjinore ose të drejtat e LGBTIQ+. *Koalicioni konservator i vlerave familjare* i amplifikon më tej këto thirrje, duke e kornizuar pjesëmarrjen në veprime publike si mbrojtje të normave morale ose kulturore. Së bashku, këta aktorë kontribuojnë në një ekosistem ku figura politike, grupe advokimi dhe platforma mediatike të rreshtuara veprojnë në sinkron për të normalizuar narrativat mobilizuese dhe për të inkurajuar forma polarizuese të angazhimit jashtë hapësirës digjitale.

Evolucioni i nxitësve kryesorë të dezinformimit të bazuar në identitet, 2022–2025

Siç ilustron në figurën në faqen pasuese, periudha korrik 2022–qershor 2025 u karakterizua nga një sekuençë e vazhdueshme ngjarjesh politike, kulturore dhe legjislativë që aktivizuan në mënyrë të përsëritur dezinformimin e bazuar në identitet në Shqipëri. Megjithatë nxitësit individualë ndryshonin—nga vendime gjyqësore dhe projektligje, te polemika kulturore, cikle zgjedhore dhe momente simbolike—të marra së bashku ato zbulojnë një model koherent: dezinformimi nuk shfaqet rastësisht, por intensifikohet sa herë që debati publik prek çështje të gjinisë, familjes, identitetit kombëtar ose orientimit të Shqipërisë drejt normave perëndimore. Në këto momente, aktorë me agjenda politike ose ideologjike i ri-kornizojnë sistematikisht debatet politike dhe ngjarjet kulturore si kërcënime ekzistenciale, duke i shndërruar zhvillimet rutinë në katalizatorë të narrativave identitare polarizuese.

Kronologjia tregon se si pika tensioni kulturore, si polemika rreth filmit të Disney-t, *Strange World*, dukshmëria në tekstet shkollorë ose ceremonia simbolike e martesës së dy grave lezbike, u rikthyen vazhdimisht ndër vite, duke gjeneruar çdo herë valë të reja komentesh sensacionale. Ngjarje ndërkombëtare—përfshirë Lojërat Olimpikë Paris 2024 ose zgjedhjet në SHBA—u lokalizuan shpejt dhe u përshtatën me narrativa vendase, duke përforcuar idenë se Shqipëria është nën presion nga “ideologjia e huaj”. Proceset legjislativë, si debatet mbi Projektligjin për Shëndetin Riprodhues apo prezantimi i projektligjit “dy gjini”, krijuan momente të tjera me intensitet të lartë, duke u mundësuar aktorëve politikë dhe grupeve të advokimit të inkorporojnë narrativa të bazuara në identitet brenda procesit formal të hartimit të politikave. Periudhat zgjedhore e amplifikuan më tej këtë dinamikë: si zgjedhjet vendore të vitit 2023 ashtu edhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 prodhuan kulme të përqendruara të mesazheve me ngarkesë identitare, ndërsa aktorët ndërthurën pakënaqësitë mbi qeverisjen me ankthin mbi kulturën, moralin dhe ndryshimet demografike.

Kronologji: Ngjarjet kryesore të lidhura me fushatat e dezinformimit të bazuar në identitet (2022–2025)



Gjatë këtyre tre viteve, fushatat e dezinformimit u bënë progresivisht më të strukturuar, më të ndërlidhura dhe më të përsëritshme. Narrativat migruan nga rrjetet sociale te portalet online dhe anasjelltas, ndërsa të njëjtët aktorë u shfaqën në qendër të episodeve të shumta, duke rafinuar dhe ricikluar pikat e diskursit sa herë që krijoheshin mundësi. Nga mesi i vitit 2025, dezinformimi i bazuar në identitet kishte evoluar nga reagim episodik në një strategji të qëndrueshme komunikimi—e aftë të aktivizojë audienca të gjera sa herë që shfaqej një nxitës i përshtatshëm.

Ky model u bë veçanërisht i dukshëm në vjeshtën e vitit 2025, kur debati publik mbi Ligjin për Barazinë Gjinore prodhoi një valë të re dhe jashtëzakonisht intensive dezinformimi. Treguesit e hershëm dëshmuar se të njëjtët aktorë, korniza dhe taktika mobilizimi të dokumentuara në ciklet e mëparshme po rishfaqeshin me koordinim dhe shpejtësi më të madhe. Debati rreth ligjit riktheu të gjitha grupet kryesore të narrativave të hartëzuara në kronologji—retorikën anti-LGBTIQ+, pretendimet për shpopullim, konspiracionet për ndërhyrje të huaj dhe kornizimin e panikut moral—duke sugjeruar se dezinformimi i bazuar në identitet kishte hyrë në një fazë më të konsoliduar dhe më të instrumentalizuar politikisht.

Për këtë arsye, monitorimi u zgjat përtej datës fillestare të përfundimit, për të mbuluar periudhën 15 shtator–15 nëntor 2025, duke garantuar që raporti të pasqyrojë mënyrën se si këta nxitës u rishfaqën gjatë një momenti legjislativ me peshë të lartë. Kjo zgjatje i mundëson raportit të dokumentojë jo vetëm shkallën e reagimit ndaj Ligjit për Barazinë Gjinore, por edhe mënyrën se si tre vite ndërtimi kumulativ të narrativave formësuan debatin publik, duke u mundësuar aktorëve të dezinformimit të mobilizohen shpejt, në mënyrë strategjike dhe me shtrirje të konsiderueshme.

Fokus i veçantë: Ligji për Barazinë Gjinore

Ky seksion shqyrton narrativat e dezinformimit të bazuar në identitet që u shfaqën rreth një ngjarjeje të vetme me pasoja të rëndësishme: miratimi i Ligjit për Barazinë Gjinore. Nga të gjitha zhvillimet e monitoruara gjatë periudhës trevjeçare, asnjë tjetër nuk gjeneroi një rritje të krahasueshme në volum, intensitet dhe koordinim të përmbajtjes së manipuluar, si në mediat online ashtu edhe në platformat e rrjeteve sociale. Për këtë arsye, ligji shërben si një rast studimor kyç për të kuptuar se si funksionon dezinformimi i bazuar në identitet gjatë proceseve legjislative me peshë të lartë.

Ligji, i miratuar nga Parlamenti më 6 nëntor 2025, u bë pika qendrore e një fushate jashtëzakonisht aktive manipulimi informativ me origjinë vendase. Aktorë politikë, grupe advokimi pro-familje dhe platforma mediatike të lidhura me ta u mobilizuan në javët që paraprinë votimin për ta kornizuar reformën si kërcënim ekzistencial ndaj familjes tradicionale, mirëqenies së fëmijëve dhe themeleve kulturore të Shqipërisë. Mesazhet e tyre u amplifikuan përmes një ekosistemi të dendur postimesh në rrjete sociale, intervistash televizive, emisionesh opinioni dhe portalesh partiake, duke krijuar një mjedis të sinkronizuar alarmi dhe mosbesimi.

Në të gjithë përmbajtjen e monitoruar, debati u formësua në mënyrë dërrmuese nga *interpretime të shtrembëruara, pretendime të gabuara dhe retorikë mobilizuese*. Koncepte qendrore të projektligjit u ri-kornizuan përmes gjuhe emocionale dhe moralizuese, duke sugjeruar se reforma do të sillte “ideologji të huaj”, do të minonte të drejtat prindërore ose do të legalizonte praktika shoqërore të kontestuara. Këto narrativa nuk synonin vetëm vetë ligjin; ato u zgjeruan më tej, duke ushqyer mosbesimin ndaj institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile, minoriteteve seksuale dhe gjinore, si dhe partnerëve ndërkombëtarë—veçanërisht institucioneve të BE-së dhe diplomatëve që mbështetën publikisht reformat për barazinë gjinore.

Për të kapur këtë përshkallëzim, të gjithë artikujt mediatikë dhe postimet në rrjetet sociale që i referoheshin ligjit u filtruan dhe u analizuan për periudhën 15 shtator–15 nëntor 2025. Ky interval kohor përkon me kulmin e debatit publik dhe mundëson një vlerësim të detajuar të mënyrës se si dezinformimi i bazuar në identitet u përdor, u amplifikua dhe u instrumentalizua gjatë procesit legjislativ.

Dezinformimi dhe kornizimi narrativ në rrjetet sociale

Duke përdorur mjetin e monitorimit të rrjeteve sociale SentiOne, u identifikuan dhe u shqyrtuan qindra postime që lidhen me Ligjin për Barazinë Gjinore. Nga ky korpus më i gjerë, studiuesit filtruan dhe koduan manualisht përmbajtjen që përmbante dezinformim, pretendime të gabuara ose kornizim narrativ që shtrembëronte konceptin thelbësor të barazisë gjinore ose sulmonte aktorët e lidhur me reformën. Llogaritë e monitoruara përfshinin figura politike, komentatorë publikë, aktivistë, influencerë dhe faqe me shtrirje të lartë në Facebook dhe Instagram, të njohura për prodhimin ose amplifikimin e përmbajtjes identitare dhe polarizuese.

Të gjitha postimet u koduan nga kodues njerëzorë për të përcaktuar nëse përhapnin narrativa të shtrembëruara, cilën narrativë specifike përdornin dhe nëse synonin individë apo institucione të caktuara. Monitorimi u përqendrua në fazën më intensive të debatit publik rreth ligjit dhe identifikoi 108 postime që buronin nga 27 llogari të ndryshme. Prej tyre, 58 u publikuan në Facebook dhe pjesa tjetër në Instagram. Së bashku, këto postime ofrojnë një prerje përfaqësuese të ekosistemit që formëson dhe amplifikon narrativat rreth gjinisë, familjes dhe normave shoqërore në Shqipëri.

Postimet u koduan në një bazë të dhënash në Excel dhe u analizuan përmes tabelave pivot. Grupet kryesore të narrativave të identifikuara në databazën e të dhënave përfshinin *kornizimin e panikut moral, teoritë konspirative, narrativa anti-institucionale/anti-elitë, stigmatizimin e shoqërisë civile dhe komunitetit LGBTIQ+*, si dhe *dezinformim/keqinformim mbi përmbajtjen e projektligjit*. Të dhënat e analizuar treguan se 58% e përmbajtjes përfshinte kornizim negativ ose alarmist, ndërsa 42% përmbante dezinformim të qartë. Fushata kundër miratimit të Projektligjit për Barazinë Gjinore në rrjetet sociale u drejtua kryesisht nga një grup aktiv figurash politike të djathta, aktivistësh/influencerësh konservatorë dhe faqesh mediatike të fokusuar në çështje identitare.

Kornizimi i panikut moral

Grupi më i spikatur i narrativave u mbështet në panik moral, duke e paraqitur projektligjin si një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj “familjes tradicionale”, roleve prindërore apo kategorive biologjike të nënës dhe babait. Postimet pretendonin se ndryshimet e propozuara përfaqësonin një rrezik ekzistencial për shoqërinë shqiptare, duke e pozicionuar ligjin si hapin e parë drejt fshirjes së normave të vendosura shoqërore dhe gjinore.

“Në protestën për mbrojtjen e fëmijëve, vetë Zoti e ka thënë me zë të lartë se ka vetëm dy gjini. Kryeministër, nëse beson se ke mbështetje publike për ligjin për gjinitë, çoje në referendum dhe do të marrësh përgjigjen e qytetarëve! Sundimi i pakicës mbi shumicën është tirani. Je i kapur nga agjenda të errëta që të mbajnë në pushtet dhe ky ishte vetëm shërbimi i radhës për to, sepse qëllimi përfundimtar është shpopullimi i Shqipërisë. Për sa monedha e shite shpirtin te djalli?!”

Shumë postime në këtë grupim e kornizojnë gjithashtu projektligjin si një sulm ndaj fëmijëve. Ato pretendojnë se ligji do të fuste ideologji të dëmshme gjinore në shkolla ose do t'i ekspozonte të miturit ndaj përmbajtjes së papërshtatshme LGBTIQ+, pavarësisht se projektligji nuk përmban asnjë nen që lidhet me arsimin. Sipas shumë prej këtyre postimeve, këto ndryshime nxiten nga aktorë vendas dhe të huaj që promovojnë një agjendë të huaj për kulturën shqiptare. Këto mesazhe synojnë të mobilizojnë reagim të fortë emocional tek lexuesit, të anashkalojnë debatin faktik mbi ligjin, ta paraqesin atë si të rrezikshëm dhe grabitqar, dhe t'i vendosin kundërshtarët e ligjit në rolin e rojtarëve moralë të shoqërisë shqiptare.

“Tubim paqësor kundër Projektligjit për Barazinë Gjinore. Le t'i mbrojmë fëmijët nga agjendat ‘woke’, le të mbrojmë familjen tradicionale.”

Teoritë konspirative

Narrativat konspirative luajtën një rol qendror në formësimin e kundërshtimit ndaj projektligjit, duke e paraqitur atë si produkt të agjendave të fshehta të nxitura nga zyrtarë të huaj, organizata ndërkombëtare ose aktorë të njohur filantropikë. Postimet shpesh akuzonin përfaqësues të BE-së, organizata LGBTIQ+ dhe grupe të shoqërisë civile se po koordinonin një projekt ideologjik të fshehtë.

Zyrtarë të lartë të BE-së—përfshirë Kreun e Delegacionit të BE-së dhe Komisioneren për Zgjerimin, —ishin objektiva të përsëritur. Postime të tjera pretendonin se aktivistët LGBTIQ+ ushtronin ndikim të padrejtë mbi institucionet shtetërore.

“Pak orë pasi 77 pisat e parlamentit shqiptar kaluan ligjin bastard nën diktatin e maskarait Soros për BE-në dhe LGBQ, në Amerikë Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi që: GJINIA duhet të regjistrohet në pasaportë që në lindje, sipas vendimit të marrë më parë nga administrata

e Presidentit Trump, dhe nuk mund të ndryshohet më kurrë me asnjë lloj raporti mjekësor të prodhuar nga mendja e sëmurë neurotike. Pra, Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi të njohë dy gjinitë që kjo botë i njej prej mijëra vitesh dhe që Zoti i Plotfuqishëm i krijoi në tokë.

Narrativa të tilla e shkëpusin ligjin nga konteksti i tij i politikave të brendshme, duke e paraqitur atë si pjesë të një komploti global që kërcënon identitetin kombëtar dhe sovranitetin.

Narrativat anti-elitë

Një tjetër grupim i spikatur përfshinte retorikë anti-elitë, duke i paraqitur institucionet politike dhe vendimmarrësit si të korruptuar, të kapur ose që veprojnë kundër interesit publik. Këto postime përdornin gjuhë tejet emocionale, duke i etiketuar deputetët dhe zyrtarët qeveritarë si tradhtarë në shërbim të agjendave të huaja.

Miratimi i ligjit në Parlament u kornizua si një akt tradhtie, duke përforcuar idenë se klasa politike injoron vullnetin e shumicës dhe vepron në shërbim të interesave të fshehta.

“Ndërsa Rilindja sorosiste e Shqipërisë, duke ndjekur udhëzimet e vetë Aleksit dhe veglave të tij në Tiranë, po votonte për të shpërbërë familjen shqiptare, në SHBA, busulla e Botës së Lirë, Gjykata e Lartë vendosi se KA VETËM DY GJINI. Dje, sekt i imoral i Rilindjes vuri në zbatim planin për të shkatërruar institucionin e familjes. Turp kujtdo që ngriti kartonin jeshil dhe turp kujtdo që hesht përballë kësaj katastrofe!”

Retorikë e tillë kanalizon frustrimin publik drejt institucioneve dhe zyrtarëve individualë, duke minuar besimin në proceset demokratike dhe duke zbehur kufirin midis mosmarrëveshjes politike dhe delegjitimitit të plotë.

Stigmatizimi i shoqërisë civile dhe i komunitetit LGBTIQ+

Stigmatizimi i aktivistëve të shoqërisë civile dhe, në veçanti, i komunitetit LGBTIQ+ u përdor gjatë debatit rreth Ligjit për Barazinë Gjinore për të minuar mbështetjen ndaj miratimit të tij dhe për të polarizuar publikun. Komuniteti LGBTIQ+ paraqitet nga kundërshtarët e ligjit si imoral dhe si kërcënim për shoqërinë dhe fëmijët. Ndërkohë, aktivistët e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut paraqiten si agjentë të interesave të huaja.

Postimet në rrjetet sociale të përfshira në databazën e të dhënave përmbajnë një model të dukshëm narrativash stigmatizuese dhe dehumanizuese që shënjestrojnë si individë ashtu edhe grupe të tëra shoqërore, me qëllim diskreditimin e tyre dhe justifikimin e armiqësisë ndaj tyre. Kjo retorikë synon t’u zhveshë atyre dinjitetin dhe i kornizon si “të huaj” që kërcënojnë strukturën morale të shoqërisë.

“JA PROVAT E NGJARJES KRIMINALE TË REKRUTIMIT DHE ABUZIMIT TË FËMIJËVE NGA ORGANIZATAT LGBQ! Kallëzim penal ndaj autorëve! Rekrutim dhe abuzim me fondet e USAID & Co.! PROBLEMI ËSHTË SE NGA E ENJTJA KJO DO TË JETË E LIGJSHME PËR TË GJITHË FËMIJËT TUAJ tani që ligji u miratua!...”

Narrativa të tilla ilustrojnë përdorimin e akuzave të rënda, gjuhës nxitëse dhe pretendimeve të pabazuara për të kriminalizuar individë dhe organizata, për të ushqyer panik moral dhe për të legjitimuar armiqësinë ndaj komunitetit LGBTIQ+ dhe shoqërisë civile.

Dezinformimi mbi përmbajtjen e projektligjit

Një tjetër narrativë që shoqëroi projektligjin për Barazinë Gjinore ishte përhapja e postimeve në rrjetet sociale që shtrembëronin ose keqinformonin mbi përmbajtjen e tij. Kjo u bë duke i atribuar projektligjit nene që nuk ekzistonin ose duke e krahasuar atë me raste ndërkombëtare të nxjerra jashtë kontekstit. Shumë postime pretendonin në mënyrë të rreme se ligji do të fuste vetë-identifikimin gjinor ose do t’u lejonte individëve të ndryshonin gjininë përmes një vetëdeklarimi të thjeshtë, ndërsa të tjera i interpretonin gabimisht nenet e përgjithshme mbi barazinë si mekanizma për fshirjen e kategorive biologjike.

Këto narrativa mbështeten në lexime selektive ose të pasakta të tekstit të ligjit për të nxitur frikë dhe konfuzion. Paralelisht, disa postime evokonin shembuj ndërkombëtarë, si rasti i Sllovakisë, por i shkëpusnin plotësisht nga konteksti i tyre politik dhe juridik.

“Berisha lexon deklaratën: Ky ligj mohon realitetin biologjik, korrupton kuptimin e gjinisë dhe imponon një rend të ri ideologjik të së majtës post-marksiste ekstreme.”

Angazhimi në rrjetet sociale

Fushata e dezinformimit rreth projektligjit për Barazinë Gjinore gjeneroi një nivel angazhimi jashtëzakonisht të lartë në Facebook dhe Instagram, pavarësisht madhësisë relativisht të vogël të databazës së të dhënave. Në total, gjatë periudhës së monitorimit u koduan 108 postime (58 në Facebook dhe 50 në Instagram), megjithatë këto postime prodhuan së bashku një nivel ndërveprimi më tipik për kriza të mëdha politike sesa për një debat të specializuar mbi politika publike.

Siç ilustron në Figurën 11, angazhimi u rrit ndjeshëm ndërsa afrohej votimi në Kuvend. Gjatë periudhës 16–30 shtator, postimet e monitoruara grumbulluan 2,647 ndërveprime, duke reflektuar aktivizimin e hershëm të rrjeteve politike dhe të advokimit sapo ligji hyri në diskutim publik. Angazhimi ra gjatë 1–15 tetorit (352 ndërveprime), një ngadalësim i përkohshëm që përkon me një fazë më të qetë të komunikimit publik.

Aktiviteti rifilloi gjatë 16–31 tetorit, me 1,391 ndërveprime, i nxitur nga mobilizimi i rinovuar dhe kornizimi gjithnjë e më alarmist nga aktorët kryesorë. Përshkallëzimi më dramatik ndodhi gjatë 1–15 nëntorit, kur ndërveprimet totale u rritën në 18,795—një kulm që përkoji me debatin parlamentar dhe miratimin e ligjit më 6 nëntor. Postimet gjatë kësaj periudhe u mbështetën fort në gjuhë emocionalisht të ngarkuar, panik moral dhe pretendime konspirative, duke nxitur reagime të gjera si nga mbështetësit ashtu edhe nga kundërshtarët.




Figura 11: Tendencat e angazhimit në rrjetet sociale gjatë debatit për Ligjin për Barazinë Gjinore

Të marra së bashku, këto modele tregojnë se një numër relativisht i vogël postimesh mund të gjenerojë angazhim në mënyrë disproporcionale të lartë kur aktivizon frikëra të bazuara në identitet. 108 postimet e përfshira në databazën e të dhënave funksionuan si katalizatorë brenda ekosistemit informativ online në Shqipëri, duke amplifikuar polarizimin dhe duke e shndërruar një reformë teknike ligjore në një konflikt kulturor me intensitet të lartë.

Narrativa polarizuese në mbulimin mediatik të Ligjit për Barazinë Gjinore

Ashtu si debati në rrjetet sociale, edhe mbulimi mediatik i projektligjit për Barazinë Gjinore u formësua nga raportimi mbi protestat kundër ligjit dhe nga narrativa të kornizuara politikisht që amplifikuan ankthin publik rreth reformës. Shumë artikuj u përqendruan në demonstratat në rrugë dhe në deklaratat e liderëve fetarë, aktivistëve dhe grupeve konservatore, të cilët e paraqitën ligjin si një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj familjes tradicionale dhe vlerave kombëtare. Si rezultat, debati publik nuk pasqyroi një diskutim teknik mbi politikën e barazisë gjinore, por një përballje më të gjerë kulturore të kornizuar përmes panikut moral dhe polarizimit të bazuar në identitet.

Duke përdorur mjetin e monitorimit SentiOne, u identifikuan 702 artikuj të lidhur me Ligjin për Barazinë Gjinore. Shumica e artikujve në databazën e të dhënave përmbanin mesazhe kundër Ligjit për Barazinë Gjinore (408), duke reflektuar një debat publik të fortë të polarizuar dhe emocional, të dominuar nga dezinformimi dhe kornizimi narrativ kundër ligjit. Një tjetër 208 artikuj kishin mbulim neutral të debatit publik lidhur me ligjin, ndërsa 86 artikuj përmbanin mesazhe në mbështetje të ligjit ose demaskonin narrativat e dezinformimit.

Grupi i artikujve përfshin një sërë narrativash të dezinformimit të bazuar në identitet që e paraqesin Ligjin për Barazinë Gjinore si një kërcënim ekzistencial për shoqërinë shqiptare. Temat dominuese përqendrohen në *panikun moral*, duke e portretizuar reformën si një sulm të drejtpërdrejtë ndaj familjes tradicionale, vlerave kombëtare dhe pafajësisë së fëmijëve, shpesh përmes sloganeve emocionalisht të ngarkuara që paralajmërojnë për “dëme ideologjike” ndaj të miturve. Këto narrativa përforcohen nga *pretendime konspirative* se ligji është i imponuar nga aktorë të huaj, që variojnë nga BE-ja deri te rrjete “globaliste”, si dhe nga mesazhe të kornizuara fetarisht që e paraqesin reformën si shkelje të rendit hyjnor. Paralelisht, artikujt shpesh stigmatizojnë dhe *dehumanizojnë personat LGBTIQ+* dhe aktivistët, duke i portretizuar si agjentë të degjenerimit shoqëror ose pjesë të një agjende të fshehtë. Debati polarizohet më tej nga retorika *anti-elitë* që akuzon qeverinë dhe Parlamentin për tradhti, korrupsion ose nënshtrim ndaj presionit të jashtëm, si edhe nga keqinformimi i përhapur ligjor që sajton pasoja që ligji nuk i përmban.

Paniku Moral

Databaza e të dhënave është e formësuar në mënyrë të theksuar nga kornizimi i panikut moral, i cili e paraqet Ligjin për Barazinë Gjinore jo si një reformë ligjore, por si një katastrofë kulturore dhe morale që po afrohet. Shumë artikuj e portretizojnë në mënyrë të përsëritur ligjin si një sulm të drejtpërdrejtë ndaj familjes tradicionale shqiptare, duke përdorur gjuhë alarmiste që evokon kolaps, korrupsion dhe degradim shoqëror. Ky kornizim përforcohet nga thirrje emocionalisht të ngarkuara për “mbrojtjen e fëmijëve”, duke sugjeruar—pa asnjë bazë ligjore—se të miturit do të ekspozohen ndaj indoktrinimit ideologjik ose rrezikut moral. Duke evokuar simbolet më të ndjeshme shoqërore si familja, fëmijëria dhe morali, këto narrativa amplifikojnë frikën dhe urgjencën, duke e shndërruar mosmarrëveshjen politike në një kërcënim të perceptuar ekzistencial. Paniku moral bëhet kështu lentja qendrore

përmes së cilës interpretohet ligji, duke mobilizuar indinjatë publike dhe duke ngushtuar hapësirën për debat faktik apo diskutim të nuancuar.

Kjo narrativë drejtohet kryesisht nga aktivistë konservatorë, liderë fetarë dhe komentatorë të rreshtuar politikisht, të cilët e paraqesin reformën si një forcë që do të "shkatërrojë" vlerat tradicionale dhe do t'i ekspozojë të miturit ndaj dëmeve ideologjike. Mesazhet e tyre evokojnë vazhdimisht mbrojtjen e fëmijëve dhe shenjtërinë e familjes si imperativat më të larta morale, duke e pozicionuar veten si rojtarë të moralit kombëtar. Objektivat kryesorë të kësaj narrative janë individët LGBTIQ+ dhe organizatat e të drejtave të njeriut, të cilët portretizohen si bartës të një agjende të rrezikshme, si dhe institucionet qeveritare dhe deputetët që mbështetën ligjin, të kornizuar si bashkëfajtorë në minimin e strukturës morale të shoqërisë.

■ Anti-gjinia

Një temë e spikatur në databazën e të dhënave të mbulimit mediatik është narrativa anti-gjinore ose e "pushtimit ideologjik", e cila e paraqet Ligjin për Barazinë Gjinore si pjesë të një ofensive më të gjerë kulturore të nxitur nga ideologji radikale, të huaja ose "woke". Postimet sugjerojnë se reforma importon një botëkuptim post-marksist ose të së majtës ekstreme, të dizajnuar për të minuar traditat shqiptare, për të zbehur dallimet biologjike dhe për të imponuar një rend të ri shoqëror. Duke e kornizuar ligjin si një "kalë Troje" ideologjik, këto narrativa e paraqesin atë jo si një vendim politikash të brendshme, por si një eksperiment kulturor të huaj të imponuar mbi një publik të pavetëdijshëm. Kjo retorikë shfrytëzon ankthin rreth identitetit dhe sovranitetit, duke e paraqitur barazinë gjinore si një mjet për erozionin e themeleve kombëtare dhe morale. Në këtë mënyrë, një amendament ligjor shndërrohet në një front simbolik të një "luftë kulturore" globale, duke rritur polarizimin dhe duke nxitur rezistencë të bazuar në frikë dhe jo në fakte.

Narrativa anti-gjinore në databazën e të dhënave drejtohet kryesisht nga një grup aktivistësh konservatorë, liderësh fetarë, komentatorësh të djathtë dhe influencerësh të rreshtuar politikisht, të cilët e pozicionojnë veten si mbrojtës të traditës dhe identitetit kombëtar. Këta aktorë përdorin rrjetet sociale, fjalime publike dhe aktivitete proteste për ta kornizuar Ligjin për Barazinë Gjinore si një imponim ideologjik të huaj dhe për të paralajmëruar për kolaps shoqëror. Mesazhet e tyre synojnë në mënyrë të vazhdueshme individët dhe organizatat LGBTIQ+, duke i paraqitur si agjentë të korrupsionit moral ose si pjesë e një agjende të fshehtë kulturore. Organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e njeriut, si Aleanca LGBT, Qendra Streha dhe OJQ të tjera advokuese, veçohen si orkestrues të këtij "pushtimi" ideologjik, të akuzuar për manipulim të të miturve ose për importim të vlerave jo-shqiptare. Paralelisht, institucionet qeveritare, shumica parlamentare dhe deputetë të caktuar që votuan pro ligjit kornizohen si tradhtarë ose bashkëpunëtorë që kanë dorëzuar sovranitetin kombëtar. Partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht Delegacioni i BE-së në Shqipëri, paraqiten gjithashtu si forca të jashtme që pretendohet se po imponojnë politika "radikale" gjinore mbi Shqipërinë. Përmes këtij grupi sulmesh, narrativa ndërton një fushëbetë morale në të cilën aktorët konservatorë e paraqesin veten si rojtarë të kombit që luftojnë kundër një koalicioni "devijantësh" vendas dhe fuqish ideologjike të huaja.

Mbulimi mediatik i Ligjit për Barazinë Gjinore përmban gjithashtu një narrativë të fortë mbi “agjendën e huaj” ose “kolonizimin kulturor”, e cila e paraqet ligjin si një projekt të imponuar nga jashtë, i dizajnuar për të riformësuar shoqërinë shqiptare sipas vlerave të huaja. Artikujt shpesh nënkuptojnë se reforma nxitet nga BE-ja, OJQ ndërkombëtare ose elita “globaliste”, duke e portretizuar Shqipërinë si një objekt pasiv të inxhinierisë ideologjike dhe jo si një aktor politik autonom. Kjo narrativë sugjeron se ligji nuk është produkt i politikëbërjes vendase, por një ndërhyrje kulturore që kërcënon identitetin kombëtar, sovranitetin dhe normat tradicionale. Duke e paraqitur ndikimin e huaj si manipulues dhe detyrues, këto mesazhe ushqejnë mosbesim ndaj partnerëve ndërkombëtarë dhe e ri-kornizojnë reformën si pjesë të një përballjeje më të gjerë gjeopolitike. Rezultati është një ndjesi e fuqishme “rrethimi kulturor”, ku barazia gjinore paraqitet jo si një nismë e bazuar në të drejta, por si një formë e kolonizimit kulturor perëndimor.

Mbulimi mediatik përmban disa teori konspirative të ndërlidhura që e paraqesin Ligjin për Barazinë Gjinore si produkt të forcave të fshehta që synojnë të riformësojnë shoqërinë shqiptare. Një teori qendrore pretendon se ligji është i imponuar nga aktorë të fuqishëm të huaj—si BE-ja, ambasadat perëndimore ose rrjete “sorosiste” globale—të paraqitur si orkestrues të një fushate kolonizimi kulturor për të zbehur identitetin kombëtar dhe vlerat tradicionale. Një tjetër teori e përhapur gjerësisht pretendon se organizatat LGBTIQ+ veprojnë si agjentë të fshehtë që manipulojnë të rinjtë, infiltronin institucionet dhe avancojnë një agjendë ideologjike nën petkun e advokimit për të drejtat e njeriut. Këto grupe përshkruhen si pjesë e një përpjekjeje të koordinuar për të seksualizuar fëmijët, për të shpërbërë familjen ose për të “rekrutuar” të mitur, pavarësisht mungesës së çdo prove. Një tjetër linjë konspirative sugjeron se ligji është një hap drejt një projekti totalitar të ri-inxhinierimit shoqëror, që supozohet se do të çojë në fshirjen e seksit biologjik dhe imponimin e një ideologjie ekstremiste të majtë. Së bashku, këto teori konspirative ndërtojnë një narrativë të Shqipërisë nën rrethim, duke e paraqitur reformën ligjore si një fasadë për agjenda të fshehta të orkestruara nga fuqi të huaja dhe aktorë vendas të rreshtuar me to.

Mbulimi mediatik i ligjit tregon se BE-ja dhe zyrtarët e saj janë objektiva të shpeshtë të dezinformimit që i paraqet si inxhinierë të një sulmi kulturor dhe ideologjik ndaj Shqipërisë. Shumë artikuj e përshkruajnë BE-në si imponuese të Ligjit për Barazinë Gjinore përmes presionit, shantazhit ose agjendave të fshehta, duke i kornizuar institucionet evropiane si forca të huaja që synojnë të minojnë identitetin, moralin dhe sovranitetin shqiptar. Përfaqësues individualë të BE-së veçohen me gjuhë denigruese, akuzohen për promovimin e vlerave “degjeneruese” ose për ndërhyrje në çështjet e brendshme, dhe paraqiten si pjesë e një komploti më të gjerë për të riformësuar strukturën shoqërore të vendit. Kjo narrativë e pozicionon BE-në jo si partnere në procesin e integritimit, por si një fuqi manipuluese që imponon ndryshime të padëshiruara, duke ushqyer kështu ndjenja anti-evropiane dhe duke minuar besimin në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Kornizimi fetar i narrativës

Narrativa e kornizimit fetar shfaqet në mënyrë të theksuar në mbulimin mediatik, ku liderë fetarë dhe komentatorë të lidhur me komunitete besimi e paraqesin Ligjin për Barazinë Gjinore si një sfidë të drejtpërdrejtë ndaj rendit hyjnor dhe së vërtetës morale. Artikujt dhe deklaratat evokojnë krijimin hyjnor, parimet biblike dhe autoritetin shpirtëror për të argumentuar se gjinia është e pandryshueshme dhe e shenjtë, duke e kornizuar reformën si një cenim të doktrinës fetare dhe si rrugë drejt degradimit moral. Duke e paraqitur ligjin si mëkat ose si shkelje të vullnetit të Zotit, kjo narrativë e shndërron një debat ligjor dhe politikash publike në një betejë shpirtërore, ku kundërshtimi paraqitet si detyrë morale, ndërsa mbështetja për ligjin barazohet me imoralitet ose devijim nga besimi. Kornizimi fetar i jep diskursit kundër ligjit një aureolë sigurie absolute dhe drejtësie morale, duke mobilizuar besimtarët dhe duke përforcuar idenë se legjislacioni kërcënon jo vetëm vlerat kulturore, por edhe themelet shpirtërore të shoqërisë.

Narrativa anti-elitë

Databaza e artikujve mediatikë të identifikuar zbulon një narrativë të vazhdueshme anti-elitë dhe anti-qeveritare, e cila i paraqet liderët politikë, deputetët dhe institucionet shtetërore si të korruptuar, të pabesueshëm dhe që veprojnë kundër interesave të popullit shqiptar. Këta artikuj e portretizojnë qeverinë si të kapur nga agjenda të huaja ose lëvizje ideologjike, duke akuzuar zyrtarët e zgjedhur për tradhti, degradim moral ose bashkëfajësi të qëllimshme në minimin e vlerave kombëtare. Deputetët që mbështetën Ligjin për Barazinë Gjinore paraqiten si “të shitur”, ndërsa vetë procesi legjislativ përshkruhet si i paligjshëm ose i manipuluar.

Kjo narrativë ushqen mosbesimin publik duke sugjeruar se klasa politike është e shkëputur nga shoqëria dhe e udhëhequr nga interesa të fshehta, dhe jo nga përgjegjshmëria demokratike. Duke delegjitimuar institucionet dhe duke e paraqitur qeverinë si kundërshtarë të popullit, narrativa anti-elitë intensifikon polarizimin dhe nxit perceptimin e një tradhtie sistematike në nivelet më të larta të pushtetit.

Stigmatizimi dhe dehumanizimi i personave LGBTIQ+

Mbulimi mediatik i ligjit përmban narrativa të përhapura që stigmatizojnë dhe dehumanizojnë personat LGBTIQ+, duke i paraqitur jo si individë me të drejta, por si kërcënime ndaj moralit, shoqërisë dhe identitetit kombëtar. Shumë artikuj përdorin gjuhë denigruese, etiketime fyese dhe insinuata për t'i përshkruar komunitetet LGBTIQ+ si imorale, grabitqare ose si pjesë e një agjende të fshehtë që synon të korruptojë fëmijët ose të shpërbëjë familjen. Kjo retorikë shkon përtej mosmarrëveshjes mbi politika publike; ajo i zhvesh personat LGBTIQ+ nga dinjiteti dhe njerëzorja, duke i rikornizuar si “të huaj” të rrezikshëm që duhet të kundërshtohen. Duke e lidhur komunitetin me degradim shoqëror, manipulim ose ndikim të huaj, këto narrativa normalizojnë armiqësinë dhe justifikojnë përjashtimin, duke e bërë të pamundur një debat konstruktiv. Kornizimi dehumanizues luan kështu një rol qendror në mobilizimin e frikës, përforcimin e stereotipeve dhe thellimin e ndarjeve shoqërore.

Një shembull domethënës i stigmatizimit dhe dehumanizimit në artikujt e shqyrtuar shfaqet në publikime që akuzojnë organizatat LGBTIQ+ për “rekrutimin” ose “abuzimin” e fëmijëve, duke i portretizuar aktivistët si grabitqarë që manipulojnë të miturit për përfitime ideologjike ose personale. Veçanërisht, grupe si Aleanca LGBT dhe Qendra Streha përshkruhen si “rrjete kriminale” që “abuzojnë me fëmijë 15-vjeçarë” dhe “manipulojnë të rinj të cenueshëm”, pavarësisht mungesës së çdo prove që mbështet këto pretendime. Gjuha e përdorur, që i referohet aktivistëve si “degjeneruar”, “të rrezikshëm” ose pjesë e një “operacioni kriminal të financuar nga jashtë”, i zhvesh individët nga njerëzorja dhe i kornizon si kërcënime ekzistenciale ndaj fëmijëve dhe shoqërisë. Ky shembull ilustron se si aktorët e dezinformimit ndërtojnë një imazh të personave LGBTIQ+ jo si anëtarë të komunitetit që meritojnë të drejta dhe mbrojtje, por si figura thelbësisht të dëmshme, ekzistenca e të cilave rrezikon kombin. Përmes kësaj taktike, paniku moral ndërthuret me dehumanizimin për të mobilizuar frikë, për të nxitur armiqësi dhe për të justifikuar kundërshtim agresiv ndaj komunitetit dhe ndaj Ligjit për Barazinë Gjinore.

Keqinformimi Ligjor

Një pjesë e konsiderueshme e mbulimit mediatik formësohet nga keqinformimi ligjor, ku postimet shtrembërojnë ose sajojnë dispozita të Ligjit për Barazinë Gjinore për të nxitur frikë dhe konfuzion. Shumë pretendime pohojnë se ligji mundëson vetë-identifikimin gjinor, fshin seksin biologjik ose u jep të drejta të gjera dhe të reja grupeve LGBTIQ+, elemente që nuk figurojnë në tekstin real të legjislacionit. Postime të tjera interpretojnë në mënyrë selektive disa nene jashtë kontekstit ose citojnë shembuj ndërkombëtarë në mënyrë të gabuar për të sugjeruar se Shqipëria po miraton politika ekstreme ose të paprecedenta. Duke shtrembëruar përmbajtjen ligjore, këto narrativa krijojnë iluzionin e një reforme radikale që kërcënon rendin shoqëror, ndonëse ligji në vetvete përqendrohet në masa kundër diskriminimit të harmonizuara tashmë me standardet evropiane. Ky keqinformim jo vetëm që minon debatin e informuar publik, por gjithashtu përforcon panikun moral dhe ushqen narrativa më të gjera konspirative rreth reformës.

Analiza e kombinuar e përmbajtjes në rrjetet sociale, mbulimit mediatic dhe evolucionit të narrativave tregon se dezinformimi i bazuar në identitet është shndërruar në një tipar përcaktues të ekosistemit informativ në Shqipëri—i cili u përshkallëzua ndjeshëm gjatë debatit mbi Ligjin për Barazinë Gjinore. Në të gjitha platformat, narrativa dominuese e kornizon barazinë gjinore, dukshmërinë LGBTIQ+ dhe të drejtat e minoriteteve si kërcënime ekzistenciale për shoqërinë shqiptare. Ky kornizim përdor vazhdimisht panikun moral, duke e lidhur ligjin e propozuar me pretendime për shkatërrimin e familjes, dëmtimin e fëmijëve dhe degradimin moral. Këto narrativa përforcohen nga një grup teorish konspirative që e paraqesin reformën si produkt të agjendave të huaja—qoftë nga institucionet e BE-së, rrjete “sorosiste” apo donatorë perëndimorë—të portretizuar si orkestrues të një kolonizimi kulturor të Shqipërisë. Paralelisht, aktorë fetarë dhe influencerë të rreshtuar me komunitete besimi i japin legjitimitet shpirtëror dezinformimit, duke i paraqitur nismat progresive ligjore si shkelje të rendit hyjnor. Në rastin e Ligjit për Barazinë Gjinore, narrativat anti-elitë amplifikojnë më tej polarizimin duke i portretizuar deputetët, ministrat, diplomatët e BE-së dhe aktivistët e shoqërisë civile si të korruptuar ose “të kapur”, duke e pozicionuar klasën politike si tradhtarë të vullnetit të shumicës. Debati mbi Ligjin për Barazinë Gjinore ilustron se si këto narrativa të përsëritura të bazuara në identitet konvergojnë në një fushatë të koordinuar të manipulimit dhe ndërhyrjes informuese vendase (DIMI) gjatë momenteve të polarizimit politik.

Në analizën afatgjatë disavjeçare, si të postimeve në rrjetet sociale ashtu edhe të artikujve mediaticë, një grup i qëndrueshëm narrativash të dezinformimit të bazuar në identitet rezulton të dominojë hapësirën informative në Shqipëri. Më e përhapura është kornizimi anti-LGBTIQ+ dhe “familje tradicionale”, që paraqet sistematikisht të drejtat LGBTIQ+, barazinë gjinore dhe dukshmërinë e minoriteteve si kërcënime ekzistenciale për shoqërinë shqiptare, moralin dhe fëmijët. Një temë e dytë e përsëritur është narrativa e kërcënimit demografik ose e shpopullimit, e cila lidh emigracionin, rënien e lindshmërisë dhe reformat progresive me frikën e rënies kombëtare. Të ndërlidhura ngushtë me to janë narrativat e ndërhyrjes së huaj dhe konspiracionit “Sorosian”, që paraqesin OJQ-të, ambasadat perëndimore dhe organizatat ndërkombëtare si orkestruese të ndryshimit kulturor kundër vullnetit të Shqipërisë. Një tjetër linjë përfshin kornizimin përmes identitetit fetar, ku vlerat konservatore dhe të bazuara në besim mobilizohen për të kundërshtuar reformat, shpesh të paraqitura si sulme ndaj fesë. Në rrjetet sociale, këto narrativa përforcohen nga linja më të reja si “kultura woke” dhe “ideologjia gjinore”, që huazojnë nga debatet globale për të paralajmëruar për erozion kulturor. Në media, të njëjtat tema inkorporohen në raportim me stil lajmi, duke u dhënë shpesh një dukje legjitimiteti. Së bashku, këto narrativa tregojnë se, ndonëse formatet dhe strategjitë e amplifikimit ndryshojnë sipas platformave, kornizat thelbësore të bazuara në identitet mbeten të njëjta, duke funksionuar në tandem për të polarizuar debatin, për të stigmatizuar minoritetet dhe për të delegjitimuar si institucionet vendase ashtu edhe partnerët ndërkombëtarë.

Narrativat e dezinformimit të bazuar në identitet, të identifikuara si në rrjetet sociale ashtu edhe në artikujt mediatikë, rrallë qarkullojnë të izoluar; përkundrazi, ato ankorohen në mënyrë strategjike në ngjarje politike, kulturore dhe ndërkombëtare që maksimizojnë dukshmërinë dhe ndikimin e tyre emocional. Në rrjetet sociale, pika kyçe përfshinin Lojërat Olimpike Paris 2024, të shfrytëzuara përmes debateve mbi sportistët transgjinjorë; filmin e Disney-t *Strange World*, të kornizuar si një përpjekje për të "indoktrinuuar fëmijët"; si dhe polemikën mbi tekstin e Gjuhës Shqipe për klasën e tretë, të paraqitur si dëshmi e "ideologjisë gjinore" që po infiltron shkollat. Në mbulimin mediatik, narrativat identitare u grumbulluan rreth cikleve zgjedhore, veçanërisht zgjedhjeve vendore të vitit 2023 dhe zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, si dhe rreth debateve legjislativë si projektligji për "dy gjini" dhe Projektligji për Shëndetin Riprodhues. Ky i fundit u paraqit si një kërcënim ekzistencial ndaj familjes dhe kombit. Si në media ashtu edhe në rrjetet sociale, u evidentuan mbivendosje rreth referencave ndërkombëtare me profil të lartë, si deklaratat e Donald Trump mbi "dy gjini", të përdorura për të legjitimuar retorikën anti-LGBTIQ+, si dhe mbulimi konspirativ i martesës së Alexander Soros, të paraqitur si dëshmi e manipulimit të jashtëm. Polemika të tjera të përsëritura përfshinin strehimin social për persona LGBTIQ+ dhe ceremonitë e martesave të të njëjtit seks, të cilat shërbyen si nxitës simbolikë për fushata dezinformimi. Këto gjetje tregojnë se dezinformimi i bazuar në identitet në Shqipëri lidhet sistematikisht me ngjarje kulturore dhe politike me dukshmëri të lartë, duke u mundësuar aktorëve të amplifikojnë narrativa për erozion kulturor, ndërhyrje të huaj dhe degradim moral.

Monitorimi tregon gjithashtu se dezinformimi i bazuar në identitet në Shqipëri është i lidhur ngushtë me modele më të gjera të manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj informative (FIMI), veçanërisht me narrativa të asociuara me operacionet ruse të dezinformimit në Evropë. Disa narrativa në postimet në rrjetet sociale dhe në artikujt mediatikë në Shqipëri pasqyrojnë drejtpërdrejt fushata ruse dezinformimi, përfshirë paraqitjen e Lojërave Olimpike Paris 2024 si simbol i rënies morale të Perëndimit përmes debateve mbi sportistët transgjinjorë, kornizimin e George Soros dhe familjes së tij si orkestrues të subversionit kulturor, si dhe stigmatizimin e të drejtave LGBTIQ+ si "ideologji woke" e imponuar nga jashtë. Këto mbivendosje tregojnë se narrativat globale FIMI lokalizohen dhe ripërdoren nga liderë politikë shqiptarë, grupe advokimi dhe media për t'i shërbyer agjendave të brendshme, ndërkohë që njëkohësisht përforcojnë objektivin më të gjerë të aktorëve FIMI për të delegitimuar institucionet perëndimore dhe për të thelluar polarizimin kulturor në Evropë. Konvergjenca midis dezinformimit vendor dhe atij të huaj nënvizon cënueshmërinë e Shqipërisë ndaj fushatave të ndikimit të jashtëm dhe thekson nevojën për masa më të forta qëndrueshmërie për të kundërshtuar si dezinformimin e prodhuar brenda vendit ashtu edhe atë të importuar, të bazuar në identitet.

Në dritën e gjetjeve të këtij studimi, autorët propozojnë një sërë masash praktike dhe të përshtatura me kontekstin, që mund të ndihmojnë në reduktimin e përhapjes dhe ndikimit të dezinformimit të bazuar në identitet në mjedisin informativ të Shqipërisë. Këto rekomandime synojnë institucione kyçe—përfshirë autoritetet publike, shoqërinë civile, organizatat mediatike dhe partnerët ndërkombëtarë—dhe janë të dizajnuara për të forcuar qëndrueshmërinë pa kërkuar reforma strukturore jorealiste.

Forcimi i ndërgjegjësimit publik dhe edukimit digjital

- Autoritetet publike, shoqëria civile dhe organizatat mediatike duhet të ndërmarrin fushata të koordinuara për edukimin mediatik dhe digjital, që i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë dezinformimin e bazuar në identitet, veçanërisht rreth temave të ndjeshme si të drejtat LGBTIQ+, barazia gjinore, migracioni dhe ndryshimet demografike.
- Qeveria dhe institucionet arsimore duhet të integrojnë module mbi mendimin kritik dhe edukimin digjital në kurrikulat shkollore, me vëmendje të veçantë ndaj mënyrës se si dezinformimi shfrytëzon vlerat kulturore, frikërat dhe shënuesit identitarë.
- Duhet të zhvillohen rregullisht aktivitete kërkimore mbi audiencat—si fokus-grupe, anketa ose analiza të ndjenjave (sentiment analysis)—për të kuptuar se cilat grupe janë më të cenueshme ndaj manipulimit të bazuar në identitet dhe si rezonojnë narrativat në demografi të ndryshme.

Përmirësimi i monitorimit dhe kapaciteteve analitike

- Institucionet publike dhe aktorët e shoqërisë civile duhet të adoptojnë një kuadër të përbashkët analitik për identifikimin dhe kategorizimin e dezinformimit të bazuar në identitet, duke garantuar konsistencë në përpjekjet e monitorimit.
- Institucionet ekzistuese—jo struktura të reja—duhet të pajisen për të shërbyer si mekanizma paralajmërimi të hershëm. Informime periodike ose panele të thjeshta monitorimi (dashboards) mund të ndihmojnë në identifikimin e narrativave të dëmshme në fazat e hershme, përpara se ato të përshkallëzohen.
- Një nismë e pavarur monitorimi—e udhëhequr nga shoqëria civile ose institucione akademike—duhet të publikojë buletine tremujore publike që përmbledhin trendet e narrativave të bazuara në identitet dhe rreziqet në zhvillim.

Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies së Platformave Online

- Autoritetet publike duhet të bashkëpunojnë me Meta-n, TikTok-un, YouTube-in dhe platforma të tjera për të sinjalizuar dhe kufizuar shtrirjen e dezinformimit të dëmshëm të bazuar në identitet, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e plotë të lirisë së shprehjes.
- Platformat duhet të inkurajohen të përshtatin praktikën e moderimit të përmbajtjes me kontekstin shqiptar, ku narrativat kulturore dhe identitare shfrytëzohen në mënyrë sistematike.
- Legjislacioni për mediat duhet të përafrohet gradualisht me Aktin e Shërbimeve Digjitale të BE-së (Digital Services Act), veçanërisht sa i përket transparencës së përmbajtjes politike të paguar dhe detyrimeve të platformave online për të zbuluar informacion mbi reklamuesit.

Mbështetja e shoqërisë civile dhe komuniteteve të cenueshme

- Autoritetet, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të ofrojnë asistencë të dedikuar ligjore, psikologjike dhe komunikimi për OJQ-të dhe aktivistët që sulmohen më shpesh nga dezinformimi i bazuar në identitet—veçanërisht organizatat LGBTIQ+, mbrojtësit e barazisë gjinore, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe gratë figura publike. Kjo mbështetje duhet të përfshijë mekanizma reagimi të shpejtë gjatë periudhave të sulmeve të intensifikuara, siç janë debatet e mëdha legjislative.
- Grupet e shënjestruara të shoqërisë civile duhet të përfitojnë mbështetje për ngritjen e kapaciteteve në sigurinë digjitale, komunikimin në krizë dhe mesazhet strategjike, duke u mundësuar atyre të përballojnë më mirë fushata të koordinuara dhe të kundërshtojnë dezinformimin pa u ekspozuar tej mase ose pa u ri-viktimizuar.
- Institucionet publike dhe partnerët duhet të mbështesin krijimin e mekanizmave konfidencialë të raportimit për aktivistët dhe grupet e cenueshme që përballen me ngacmime digjitale, gjuhë urrejtjeje ose fushata të koordinuara manipulimi, duke garantuar që rastet të dokumentohen, të përshkallëzohen dhe të trajtohen.
- Shoqëria civile duhet të kultivojë angazhim me institucionet fetare dhe liderët komunitarë për të ndërtuar qëndrueshmëri ndaj keqpërdorimit të kornizimit fetar identitar, duke amplifikuar zëra të moderuar që promovojnë përfshirjen, tolerancën dhe debat publik të bazuar në fakte.

Forcimi i integritetit mediatic dhe raportimit të përgjegjshëm

- Redaksitë shqiptare duhet të miratojnë udhëzime editoriale vullnetare për raportimin mbi tema të ndjeshme identitare, duke ndihmuar gazetarët të shmangin amplifikimin e dezinformimit ose narrativave stigmatizuese.

- Shoqatat e gazetarëve, universitetet dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të ofrojnë trajnime të synuara mbi dezinformimin e bazuar në identitet, raportimin e sigurt mbi çështjet LGBTIQ+ dhe kontekstualizimin e debateve polarizuese.
- Mediat duhet të shmangin riprodhimin pa analizë të kornizimeve të dëmshme dhe të garantojnë që mbulimi që përfshin komunitete të cenueshme të përmbajë informacion faktik dhe të bazuar në të drejta.

Rritja e qëndrueshmërisë zgjedhore

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të sanksionojë liderët politikë, partitë dhe kandidatët që përhapin dezinformim të bazuar në identitet gjatë fushatave zgjedhore, veçanërisht kur këto narrativa kontribuojnë në polarizim jashtë hapësirës online.
- Partitë politike duhet të miratojnë dhe të angazhohen publikisht ndaj kodeve të sjelljes për fushata të përgjegjshme, veçanërisht në hapësirën digjitale, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira demokratike evropiane.

Forcimi i komunikimit me reagim të shpejtë

- Institucionet publike duhet të përmirësojnë kapacitetin e tyre për t'iu përgjigjur shpejt pretendimeve të rreme të bazuara në identitet. Shpjegime të shkurtra faktike, pyetje-përgjigje (FAQ) ose postime që demaskojnë mite të publikuara në kanalet zyrtare mund të ndihmojnë në parandalimin e konfuzionit dhe uljen e përshkallëzimit të narrativave.
- Agjencitë qeveritare dhe institucionet e pavarura duhet të koordinohen në mënyrë informale me shoqërinë civile dhe mediat për të garantuar që sqarimet mbi çështje të ndjeshme të shpërndahen gjerësisht dhe me shpejtësi.

Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të forcojnë bashkëpunimin me partnerë rajonalë dhe rrjete evropiane të verifikimit të fakteve për të identifikuar përhapjen ndërkufitare të narrativave dhe për të zbuluar versione të përshtatura lokalisht të trendeve globale të dezinformimit.
- Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare duhet të përqendrohet në mjete praktike, metodologji të përbashkëta dhe mbështetje teknike, në vend të arkitekturave të reja komplekse që tejkalojnë kapacitetin institucional të Shqipërisë.

Shtojca 1: Kodifikimi i rrjeteve sociale

Për kodimin e postimeve në rrjetet sociale u përdorën kategoritë e mëposhtme, bazuar në kuadrin ABCDE të analizës së dezinformimit.

Aktori (A)
A1: Lider politik/parti
A2: Media/gazetar
A3: Aktivist/grup advokimi
A4: Influencer në rrjete sociale
A5: Media shtetërore e huaj
A6: I paspecifikuar
A7: Lider fetar/institucion fetar
Sjellja (B)
B1: Kornizim i përgjithshëm/opinion
B2: Mobilizim/thirrje për veprim
B3: Deklaratë publike/koment
B4: I paspecifikuar
Përmbajtja (C)
C1: Kornizim anti-LGBTIQ+/"familje tradicionale"
C2: Narrativë e kërcënimit demografik/shpopullimit
C3: Ndërhyrje e huaj/konspiracioni "Sorosian"
C4: Kornizim përmes identitetit fetar
C5: Narrativë e përgjithshme politike/shoqërore
C6: I paspecifikuar

Shkalla (D)

D1: E lartë—potencial mobilizimi

D2: E mesme—nxitës emocional

D3: E ulët—informative

Efekti (E)

E1: Nxit veprim jashtë hapësirës online; përforcon polarizimin politik

E2: Përforcon ndjenjat anti-LGBTIQ+ dhe polarizimin kulturor

E3: Forcon frikërat e shpopullimit; ushqen mosbesimin ndaj institucioneve

E4: Delegjtimon OJQ-të dhe ndikimin ndërkombëtar

E5: Amplifikon ndarjet mbi identitetin fetar

E6: Formësim i përgjithshëm i opinionit

Kategori shtesë kodimi për postimet në rrjetet sociale

Grupi i shënjestruar

B1: Komuniteti LGBTIQ+

B2: Fëmijë/familje

B3: Mësues/edukatorë

B4: Institucione/OJQ

B5: Vlera fetare ose nacionaliste

B6: Publiku i përgjithshëm

Karakteristikat e formatit

D1: Meme vizuale/imazh

D2: *Hashtag-e*

D3: Përmbajtje video

D4: Link i jashtëm

D5: Kornizim fetar

Shtojca 2: Kodifikimi i artikujve mediatikë

Për kodimin e artikujve mediatikë u përdorën kategoritë e mëposhtme, bazuar në kuadrin ABCDE të analizës së dezinformimit.

Aktori (A)
A1: Lider politik/parti
A2: Media/gazetar
A3: Aktivist/grup advokimi
A4: Influencer në rrjete sociale
A5: Media shtetërore e huaj
A6: I paspecifikuar
A7: Lider fetar/institucion fetar
Sjellja (B)
B1: Kornizim i përgjithshëm/opinion
B2: Mobilizim/thirrje për veprim
B3: Deklaratë publike/koment
B4: I paspecifikuar
Përmbajtja (C)
C1: Kornizim anti-LGBTIQ+/"familje tradicionale"
C2: Narrativë e kërcënimit demografik/shpopullimit
C3: Ndërhyrje e huaj/konspiracioni "Sorosian"
C4: Kornizim përmes identitetit fetar
C5: Narrativë e përgjithshme politike/shoqërore
C6: I paspecifikuar

Shkalla (D)

D1: E lartë–potencial mobilizimi

D2: E mesme–nxitës emocional

D3: E ulët–informative

Efekti (E)

E1: Nxit veprim jashtë hapësirës online; përforcon polarizimin politik

E2: Përforcon ndjenjat anti-LGBTIQ+ dhe polarizimin kulturor

E3: Forcon frikërat e shpopullimit; ushqen mosbesimin ndaj institucioneve

E4: Delegjitimon OJQ-të dhe ndikimin ndërkombëtar

E5: Amplifikon ndarjet mbi identitetin fetar

E6: Formësim i përgjithshëm i opinionit

**Narrativat e përçarjes:
Hartëzimi i dezinformimit të
bazuar në identitet në Shqipëri**

MONITORIMI I EKOSISTEMIT TË INFORMACIONIT
NË SHQIPËRI (2022–2025)

